



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 17:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Milva Ekonomi – Zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe miratimi në parim i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".
2. Miratimi në parim, nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar""
3. Diskutimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Ramazan Gjyzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Klajdi Qama, Erion Piciri, Besnik Baraj (zëvendësues) dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Enada Kapllani dhe Amra Barova.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë,

Besmir Beja – drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë,

Irena Malolli - drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,
Enea Karakaçi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,
Gentian Sala – Kryetar i AMA-s,
Sara Xhumbari- drejtore juridike e AMA-s,
Jetmir Braha – përfaqësues i AKEP-it,
Elira Kokona – përfaqësuese e Zyrës Juridike të Këshillit të Ministrave,
Si vëzhgues:
Ermira Zharri – përfaqësuese e OSBE-së,
Enisa Karanxha – përfaqësuese e Zyrës së Këshillit të Europës.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Mendova se orët e gjata të pritjes në fillim të mbledhjes së komisionit do të shërbenin për të reflektuar lidhur me propozimet e ndërkombëtarëve apo edhe thirrjes së organizatave mediatike të profesorëve që kishim këtu, por, mesa duket, pjesa më e madhe dëshiron që ta kalojë. Uroj që t’i reflektoni ju ato dhe ta tërhiqni projektligjin!

Të nderuar gazetarë dhe përfaqësues të medias,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Anëtarë të komisionit dhe deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Në cilësinë e kryetares së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke parë se maxhoranca e komisionit që drejtoj, si edhe Kuvendi i Shqipërisë nuk po jep asnjë shenjë tërheqjeje për dy projektligjet e hartuara nga qeveria, të njohura si “paketa antishpifje”, përkundrazi, me arrogancën që e karakterizon, rrezikon t’i shndërrojë ato në ligj me forcën e kartonëve në parlament, ju drejtohem me anë të kësaj deklarate, përmes së cilës shpreh qëndrimin tim lidhur me rrezikun që paraqesin këto dy projektligje për lirinë e fjalës dhe medieve.

Prej momentit që dy projektligjet kanë ardhur në komision, e shqetësuar për pasojat e rënda që ato do të kenë për lirinë e medieve dhe të ushtrimit të profesionit të gazetarit në Shqipëri, jam përpjekur që përmes seancave dëgjimore në komision, të thërras përfaqësuesit e organizatave mediatike, të botës universitare, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare për të marrë një mendim sa më të gjerë dhe të kualifikuar për projektligjet në diskutim. Thua jse të gjitha grupet e ftuara në komision janë shprehur të shqetësuara për thelbin e këtyre dy projektligjeve dhe kanë kërkuar tërheqjen e tyre nga procedura parlamentare.

Duke e sintetizuar qëndrimin e tyre për këto dy projektligje, ata kanë theksuar:

Së pari, projektligjet i japin AMA-s kompetenca të tilla, që e shndërrojnë atë praktikisht në një organ të censurës për mediet *online*. AMA, me kompetenca të zgjeruara, përveçse në fushën e medieve audiovizive dhe në fushën e medieve elektronike, fiton kompetenca të tilla që në mënyrë arbitrare mund të mbyllë media apo të vendosë gjoba të tilla, që janë të papërballueshme për to.

Së dyti, me kompetencat që ligji i jep AMA-s, ky institucion merr kompetencat e organeve gjyqësore dhe ligji nuk jep asnjë garanci ligjore që mbron mediet nga vendimet e mundshme arbitrare.

Problemet që adreson projektligji, si “shpifja”, ka mundësi të zgjidhen përmes legjislacionit ekzistues dhe për këtë arsye, ata kanë argumentuar se nuk ka nevojë për projektligje të tilla.

Problemet që adresojnë projektligjet janë çështje të vetërregullimit të medieve dhe nuk mund të shndërrohen në ligj, pasi, sipas mendimit të specialistëve, aty ku vetërregullimi shndërrohet në ligj, jemi në sistemin e censurës.

Këtë qëndrim të ligjit të shprehur qoftë në komision, qoftë në forma të tjera e kanë mbajtur përfaqësues të BE-së përmes ekspertit të tyre në komision, të OSBE-së përmes zotit Harlem Desir, të Këshillit të Europës, 15 organizata mediatike të paraqitura në komision, përfaqësuesit e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit të ftuara në komision në cilësinë e ekspertit, 35 organizata ndërkombëtare që militojnë për lirinë e medieve, partitë kryesore të opozitës dhe shumë personalitete të rëndësishme të medieve, kulturës dhe botës akademike.

Për mua është shumë e qartë tashmë se këto dy projektligje përbëjnë një kërcënim të madh dhe një sulm të rëndë që i bëhet lirisë së fjalës në përgjithësi dhe lirisë së medieve në vendin tonë.

Dy projektligjet përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe konventave ndërkombëtare të nënshkruara nga shteti shqiptar.

Në shenjë solidariteti me shqetësimin e medieve, komuniteti ndërkombëtar dhe mbarë opinioni publik shqiptar, në pamundësi për të ndikuar sadopak në pengimin e kësaj marrëzie nga komisioni që unë drejtoj, por edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, shpall bojkotin e komisionit dhe parlamentit deri në tërheqjen e këtyre projektligjeve nga procedura parlamentare.

U kërkoj deputetëve të marrin parasysh pasojat e rënda që do të ketë miratimi i këtyre dy projektligjeve për lirinë e medieve dhe demokracinë shqiptare dhe të bojkotojnë procesin, duke e detyruar qeverinë të tërhiqet nga këto dy projektligje.

Prej këtij momenti, i bashkohem protestës së gazetarëve dhe qytetarëve, si dhe kauzës së tyre të drejtë për mbrojtjen e lirisë së fjalës dhe medieve.

Shqyrtimin e projektligjit të dëshiruar prej qeverisë prej Kryeministrit, që e propagandon kaq shumë, mund ta vijoni vetë, meqenëse keni të drejtën e vetos dhe votat.

Unë nuk bëhem palë në asnjë paketë të quajtur antishpifje në këtë komision!

Faleminderit!

(Kryetarja, zj. Dhimitri, largohet.)

(Mbledhja e Komisionit vijon nën drejtimin e zëvendëskryetares, znj. Ekonomi.)

Milva Ekonomi – Kolegë, mendoj se nuk është rasti të bëjmë asnjë koment. Qëndrimi që mban kryetarja e komisionit nuk është hera e parë e këtij lloji, është qëndrim i përsëritur. Përveç

qëndrimeve politike, ka edhe qëndrime etike, që nuk janë të përshtatshme, kështu që nuk ia vlen të diskutojmë. Në këtë moment të mbyllim çdo lloj diskutimi lidhur me qëndrimin që ka mbajtur kryetarja dhe të vazhdojmë të bëjmë detyrën për të diskutuar për paketën dhe për dy ligjet si pjesë të saj.

Ky komision ka vendosur, dhe jo kryetarja, që është shumë e rëndësishme, të bëjë një listë dëgjësash shumë të gjata. Nëse do të vëmë në punë kujtesën, do të na kujtohet që kemi thirrur 11 grupe interesi. Vendimi ynë ka qenë për të dëgjuar sa më shumë opinione, nga ana tjetër, të gjithë bashkë kemi qenë shumë të gatshëm që relatorët që kemi caktuar në komision të punojnë ngushtë me Komisionin e Ligjeve dhe mos e harroni edhe këtë fakt, ne kemi qenë shumë të kujdesshëm për sa i përket teknikës legjislative. Fakti që po bëjmë mbledhje në këtë orë të pasdites është që Komisioni i Ligjeve duhet të përfundonte detyrën e tij. Meqenëse ne kemi pasur edhe gjykime dhe opinione të ndryshme nga BE-ja, OSBE-ja apo nga Këshilli i Europës, kërkuam që diskutimi i këtij projektligji ose, më mirë, i paketës së dy projektligjeve në parim, të bëhej në një moment të dytë.

Duke qenë se sot kemi diskutimin në parim të projektligjit, pastaj nen për nen dhe në tërësi, në komision kemi ftuar ministren e Drejtësisë, zonjën Etilda Gjonaj, përfaqësues të AMA-s dhe AKEP-it, si dhe të ftuar nga zyra juridike e Këshillit të Ministrave.

Seanca e sotme është e plotë dhe do të vazhdojmë me diskutimet. Zoti Piciri, keni fjalën për procedurë.

Erjon Piciri – Siç dihet, i keni numrat dhe votat, por të paktën na lini dy minuta të mbajmë një qëndrim publik.

Në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë dhe anëtarit të Komisionit të Edukimit dhe Medias, i kërkoj qeverisë shqiptare të tërheqë dy projektligjet e “paketës antishpifje”, që në fakt janë projekte të pastra të censurës së policisë politike dhe kapjes së medias.

I bashkohem thirrjes së opinionit të shëndetshëm publik, të atyre 15 organizatave vendase të gazetarëve dhe shoqërisë civile, si dhe të 35 organizatave ndërkombëtare që kërkojnë tërheqjen e menjëhershme të këtyre dy projektligjeve nga axhenda e parlamentit.

Shqipëria vuan prej 75 vjetësh, në mos më shumë, pasojat e një tradite të munguar demokratike dhe reflekseve sunduese të partisë shtet. Ne jemi ende një vend pjesërisht i lirë, një ndër 10 vendet e fundit të Europës sipas “Freedom Hous”, vendi i 82-të nga 180 sipas “Reporterët pa kufi” në indeksin e lirisë së shtypit, një rënie prej 7 vendesh në vitin 2017. Raporti i fundit i “Reporterëve pa kufi” thotë: “Sulmet ndaj medias nga të dyja, qeveria dhe krimi i organizuar ,

arritën një nivel të paprecedent në vitin 2018”, një sintagmë e padëgjuar në një vend tjetër “qeveria dhe krimi i organizuar”. Kjo besoj se është e patolerueshme.

Unë u bëj thirrje deputetëve socialistë të këtij komisioni dhe Kuvendit në tërësi, të ngrihen në nivelin e ligjvënësve të përgjegjshëm, të mos lejojnë sot një grusht shteti institucional të shkatërrimit të principeve demokratike të ndarjes, balancimit dhe kontrollit të pushteteve. Tentativa diktatoriale e kapjes së medias është një akt antidemokratik, antikombëtar dhe antieuropian, që e hedh Shqipërinë drejt modelit alla rus të republikave të dështuara ish-sovjetike.

Ndonëse Partia Socialiste është pasardhëse e Partisë Komuniste, ajo nuk duhet t’i rikthehet trashëgimisë bolshevike, nuk duhet të lejojë më kurrë mendjet e sëmura të venë dorë mbi shtetin ligjor dhe demokratik dhe mbi të drejtat themelore të njeriut.

Një karrige politike ka vlerë kur i shërben lirisë së kombit, jo kur nxjerr përfitime klanore nga nënshtrimi politik i tij. Një prijës apo kastë partie nuk mund të jenë kurrë mbi ndërgjegjen, principet dhe vlerat e një ligjvënësi.

Këtu do të dal pak nga teksti me një parantezë të shkurtër: unë jam pjesë e këtij parlamenti, sepse refuzova që një parti politike ta marrë pushtetin nga rruga, sepse në shekullin XXI marrja e pushtetit nga rruga, sikurse cenimi i kontrollit dhe balancimit të pushteteve, janë disa principe që na ndajnë nga e shkuara, ndaj është një sinjal alarmi për këtë që po ndodh sot në Shqipëri.

Është koha t’i formësojmë partitë dhe prijësit, dhe jo të infektohem nga shpirti dekadent i pushtetarëve autoritarë. Masmedia në Shqipëri ka problemet e veta dhe duhet të pastrohet nga ndikimet politike dhe korruptive, por këtë operacion duhet ta kryejë drejtësia, pjesa e shëndetshme e medias në aleancë me publikun pa censurën e një prej tri qeverive më të korruptuara të Europës sipas *Transparency International*. Mund të buzëqeshë kush të dojë, por jemi një nga tri qeveritë më të korruptuara të Europës dhe ata që janë politikanë prej shumë vitesh në këtë vend, them se duhet të reflektojnë.

Shpifjet duhet të zgjidhen nga gjykatat civile, jo nga gjykatat politike të institucioneve administrative të emëruara nga maxhorancat e Kuvendit. Lajmet e rreme duhet të ndëshkohen nga audienca, nga trupa profesionale e medias, jo nga qeveritë që janë në konflikt interesi dhe që e përdorin këtë luftë si pretekst për kapjen e të gjitha pushteteve.

U bëj thirrje qytetarëve shqiptarë përmes medias, të ruajnë demokracinë dhe lirinë e shtypit, kjo e dallon një komb të prapambetur nga një komb i civilizuar.

Më shpejt duhet të bjerë një qeveri, sesa të cenohet një liri!

Në shenjë kundërshtimi të plotë, largohem edhe unë nga mbledhja e Komisionit të Edukimit dhe Medies, me bindjen se këto dy projektligje nuk duhet të diskutohen nen për nen, por të refuzohen në princip si të papranueshme me frymën kushtetuese të demokracisë dhe lirisë së shprehjes në Shqipëri.

Ju faleminderit!

Milva Ekonomi – Ne vazhdojmë pjesën tonë.

Kolegë, ju kujtohet që kishim caktuar dy relatorë për projektligjin, por para se t'ua jap fjalën, do të pyesja ministren Gjonaj nëse do të donte të shtonte diçka, para se të kalojmë në votimin në parim.

Etilda Gjonaj – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Në fakt, nuk po ndalem te komentet që u bënë lidhur me korrupsionin e qeverisë dhe gjitha elementet që u shprehën deri tani, se unë nuk kam parë ndonjë raport që të thotë se qeveria shqiptare është një ndër tri qeveritë më të korruptuara, kështu që do të lutesha që edhe kur citohen raporte të tilla, të jemi të saktë, me qëllim që të mos ta dizinformojmë publikun, për më tepër që antikorrupsioni është një fushë përgjegjësie e Ministrisë së Drejtësisë. Duke mbajtur këtë në konsideratë dhe duke qenë koordinatorë kombëtarë antikorrupsion, do të vlerësoja se çdo lloj kritike dhe sugjerimi, do të duhet të ishte i bazuar mbi fakte, mbi raporte që nxjerrin disa rezultate të qenësishme dhe jo thjesht mbi baza deklaratash politike, që u shërbejnë vetëm individëve dhe as debatit në komision, dhe as publikut.

Le të kthehemi te projektligjet e propozuara nga qeveria, që kanë qenë për diskutim në komisionet e Kuvendit në këtë periudhë. Do të ndalesha shkurtimisht në dy, tri momente, nëse do të më lejoni, që kanë të bëjnë me qartësimin e qëllimit apo nevojës së kësaj nisme, meqenëse është ende diskutimi në parim i këtyre dy paketave, për të shmangur çdo lloj konfuzioni që është krijuar lidhur me to.

Mund të them se disa nga nevojat që janë parë në momentin që janë hartuar të dy projektligjet, ku janë marrë në konsideratë modelet e 28 vendeve të Bashkimit Europian se si është rregulluar ky legjislacion, sidomos në vendet me demokraci shumë më të konsoliduar, ne kemi marrë aspektet më të mira për t'i bërë pjesë të këtyre dy projektligjeve, të cilat, në radhë të parë, kanë synim të kenë rregulla substanciale dhe procedurale pro fluksit të shërbimeve të publikimeve elektronike, me qëllim që të parandalohet cenimi i dinjitetit dhe i reputacionit të individëve, duke parandaluar njëkohësisht edhe ekspozimin e të miturve, që ka qenë një ndër rekomandimet e

kahershme jo vetëm të aktorëve të shoqërisë civile, por të gjitha organizatave ndërkombëtare që kanë në fokus kryesor interesin më të lartë të të miturve, por njëkohësisht edhe parandalimin e ekspozimit të të gjithë qytetarëve nga nxitja e gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe një sërë elementeve të tjera.

I dyti ka të bëjë pikërisht me rregulla të qarta procedurale për sigurimin e një mbrojtjeje efikase të të gjitha të drejtave të personave fizikë dhe juridikë publik apo privatë, nëpërmjet një mjeti procedural administrativ të shpejtë dhe efikas, që ka të bëjë me ankimin në rastet kur ka përhapje të një informacioni të rremë, tendencioz, të pasaktë, ashtu dhe në marrjen e një mase të shpejtë në favor të mbrojtjes së të drejtave.

Gjithashtu, të dyja ndryshimet që kanë ardhur garantojnë respektimin e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit të tregut të medias elektronike, mbajnë në konsideratë rregullat që sigurojnë vendosjen e standardeve etike, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e informimit dhe diskursit publik, si të ofruesve të shërbimit audiovizual, por edhe atyre elektronik; njëkohësisht bëhet edhe një harmonizim i rregullave ku bazohet veprimtaria e ofruesve të shërbimeve elektronike, njësoj si ata që ofrojnë shërbime audiovizuale, gjithashtu rregulla të qarta edhe për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtat e lidhura me to.

Është për t'u theksuar se nga e gjithë analiza që u është bërë legjislacioneve të 28 vendeve anëtare të Bashkimit European, mund të theksoj se edhe parlamenti francez ka miratuar së fundi ligjin “*Antifake news*” në nëntor të vitit 2018, duke krijuar rregulla të reja, për t'u dhënë fuqi autoriteteve për të hequr përmbajtjen e rreme të përhapur përmes medieve sociale, madje edhe për të bllokuar vendet që e publikojnë atë, elementë të cilët janë të përfshirë edhe në propozimet që po shqyrtoni dhe diskutoni sot.

Gjithashtu, edhe në Gjermani është miratuar ligji për përmirësimin e zbatimit të ligjit në rrjetet sociale, që daton pikërisht me hyrjen në fuqi më 1 janar 2018, ku platformat *online* përshtatin veprimtarinë e tyre në përputhje me detyrimet në zbatim të këtij ligji.

Disa nga risitë që sjell paketa ligjore shqiptare kanë të bëjnë njëkohësisht me disiplinimin dhe normimin me ligj të shërbimit të medias në tërësi dhe të publikimeve elektronike në veçanti, kjo edhe për shkak të rritjes së impaktit social-ekonomik-kulturor dhe politik të shoqërisë shqiptare, por edhe për faktin që zhvillimi teknologjik dhe informatik ka avancuar shumë dhe do të duhet që edhe në aspektin legjislativ, të dy këto rregullime ose, më saktë drejtime, të rregullohen po njësoj.

Mund të them, gjithashtu, se jo vetëm që janë mbajtur në konsideratë legjislacionet e vendeve të ndryshme, duke i konsideruar me një demokraci shumë të konsoliduar, por, nga ana tjetër, janë mbajtur në konsideratë edhe rekomandimet e Parlamentit European për shtetet anëtare të Bashkimit European, që kanë të bëjë pikërisht me direktivën për shërbimin e medias audiovizuale, ku kërkohet të amendohet dhe t'u kërkojë shteteve anëtare që të sigurojnë lirinë dhe pluralizmin e tregut të medias audiovizuale, e cila gjen vend në të dy propozimet që kanë ardhur.

Një rekomandim tjetër ka të bëjë pikërisht me ngritjen e një *database* që të përmbajë informacionin për të gjithë pronarët e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të medieeve, gjithashtu gjen reflektim në propozimet e ardhura, por duke parë dhe mbajtur në konsideratë edhe zhvillimet, edhe modelet, siç është modeli i Kroacisë, i cili është mbajtur në konsideratë momentin që janë hartuar ndryshimet, duke pasur parasysh edhe regjistrimin, por jo si një parakusht të këtyre subjekteve, me qëllim që të kenë një regjistrim sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

Me anë të këtyre parashikimeve ligjore të propozuara, regjistrimi i portaleve *online* apo mediave, është vetëm për efekt të krijimit të një *database* zyrtar dhe ai nuk kërkon marrje licence, por vetëm paraqitjen e një numri identifikimi.

Së fundi, duke pasur parasysh edhe diskutimet që janë bërë edhe në Komisionin e Ligjeve apo në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, një sërë rekomandimesh, bashkë me stafin e ministrisë, pa dyshim, edhe me zonjën Kokona, që përfaqëson Kryeministrinë dhe është një ndër njohëset më të mira të kësaj fushe apo edhe të praktikës ndërkombëtare, kemi vënë re se rekomandimet e OSBE-së janë të gjitha të reflektuara në projektligj dhe aty ku ka nevojë për ndonjë ndryshim, i cili i përmirëson të dy projektligjit dhe paketën në tërësi, jemi të gatshëm t'i rishikojmë dhe diskutojmë bashkërisht.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Ministre!

Para se t'ua jap fjalën kolegëve, do të doja të pyesja zonjën Kokona në qoftë se do të shtonte diçka, apo do të donit të jeni pjesë aktive e diskutimeve nën për nen?

Faleminderit!

Zoti Ulqini, doni të shtoni diçka?

Musa Ulqini – Faleminderit, zonja kryetare!

Ne kemi bërë diskutime në komision, ku i kemi thënë të gjitha gjërat, por për shkak të vëmendjes së shtuar të opinionit publik, jo vetëm të komunitetit të gazetarëve, si një nga relatorët

e këtij projekti, duke marrë në konsideratë edhe çka u tha pak më parë nga kryetarja e komisionit, dua të plotësoj disa gjëra apo të ripërsëris pak më ndryshe disa prej gjërave që u thanë këtu, edhe nga ministrja e Drejtësisë.

Së pari, të gjithë duhet ta kuptojmë që ky ligj ka gati 1 vit që po diskutohet dhe nuk është e vërtetë, siç thuhet nga deklaratat, nuk e kam fjalën për kundërshtarët politikë, sepse ata i mirëkuptoj, as për ata, të cilëve u preken interesat, pasi një pjesë e atyre që reagojnë në mënyrë të ashpër janë në konflikt të pastër interesi, kemi pasur fatin të kishim në komision njerëz, të cilët janë në konflikt të pastër interesi dhe gjuha e përdorur nga ana e tyre ishte e paprecedentë në historinë e komisionit, por e kam fjalën për mediet, gazetarët, komunitetin e gazetarëve, si dhe qytetarët që kanë shqetësime sa i takon këtij projektligji.

Është e vërtetë që ky projekt ka ardhur nga qeveria, ndryshe nga tradita e deritanishme që ligjet që rregullojnë aktivitetin e medieve janë prodhuar nga ky komision. Ky është i vetmi rast, në respekt të së drejtës së plotë që ka qeveria dhe të Kushtetutës. Në parlament ligjet vijnë nga qeveria dhe në raste të veçanta vijnë nga një numër i caktuar deputetësh dhe nga 20 mijë qytetarë. Qeveria aktuale është një qeveri legjitime e dalë nga zgjedhje legjitime dhe mendoj se në këtë aspekt, nuk ka ndodhur asgjë që të cenojë gjithçka demokratike që funksionon në një republikë parlamentare siç jemi ne. Në të njëjtën kohë, qeveria ka pasur vullnetin e mirë që për 1 vit rresht të mos e sillte këtë ligj në parlament, duke marrë në konsideratë të gjitha shqetësimet që janë shprehur hapur publikisht, por edhe në mënyra të tjera, nga komuniteti i gazetarëve dhe nga të gjithë grupet e interesit. Janë bërë 4 tavolina, aq sa unë kam dijeni, kjo mund të konfirmohet edhe nga përfaqësuesit e grupit të punës, janë ftuar njerëz të rëndësishëm, që përfaqësojnë shoqatat dhe organizatat e medieve, të cilët ose nuk kanë shkuar, ose kur kanë shkuar, kanë folur në përgjithësi, por nuk kanë qenë produktivë për të dhënë shpjegime të qarta se për çfarë ata ishin kundër dhe si mund të rregullohej problemi që ata kishin. Janë bërë 6 raunde bisedimesh me OSBE-në.

Dua të theksoj diçka për publikun. Me aq sa kam kuptuar, të gjithë faktorët ndërkombëtarë që monitorojnë medien në Shqipëri kanë rënë dakord që për këtë çështje violinë e parë të jetë zyra e medias e OSBE-së me qendër në Vjenë, pasi atje është prezenca e Bashkimit Europian, e Këshillit të Europës, organizatave të ndryshme të OKB-së, si dhe organizata të tjera, të cilat janë shumë të ndjeshme, kur vjen fjala për ndryshimet që i bëhen legjislacionit të medias. Kjo është arsyeja që qeveria ka bërë 6 takime ose tavolina, në të cilat kanë qenë të pranishëm edhe ekspertë të OSBE-së dhe si rezultat i këtyre bisedimeve, ka pasur përmirësime, qartësime dhe sot kemi 2-3 çështje,

të cilat janë duke u qartësuar dhe rregulluar. Mendoj se këto çështje nuk janë arsyeja për ta quajtur ligjin të rëndomtë nga kundërshtarët, siç e theksova më sipër, politikë, apo ata që kanë konflikt interesi, sepse ky ligj ka pasur përmirësime, kjo si rezultat i vullnetit të treguar nga ana e qeverisë për t'i bërë këto ndryshime.

E dyta, ne, si komision, kemi bërë një procedurë që rrallë është bërë në këtë komision dhe në këto përmasa. Pse e them këtë? Këtu nuk ka qenë vullneti i individit, por vullneti ynë. Ne u kemi kërkuar me shkrim të gjithë aktorëve që janë në Shqipëri, e kam fjalën për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, të ishin të pranishëm në komision, jo vetëm në një seancë, por në të gjitha debatet që organizohen. Kemi ftuar kundërshtarët më me zë që të jenë të pranishëm, të cilët kanë ardhur këtu dhe na kanë paragjykuar në mënyrën më të pashembullt. Këto seanca quhen “seanca dëgjimore”, që do të thotë se i kemi ftuar për t'i dëgjuar, ndërkohë që ne, si përfaqësues të komisionit, nuk ishim shprehur ende.

Sot është dita që ne, si deputetë, të shprehim mendimin tonë për projektin në fjalë. Këtë nuk e kemi bërë me 1, 2 apo 3 organizata që i pëlqejnë Kryeministrit, Milvës, ministrave apo disa relatorëve, por e kemi bërë me të gjithë ata që janë pjesë e këtij procesi, që preken dhe kanë lidhje me këto projekte, dhe janë të regjistruar në *databazën* e Kuvendit të Shqipërisë, sipas Rregullores. Kemi ftuar 11 grupe, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të shoqatave të medieve, sepse nuk është e njëjta gjë si të ftosh shoqatat e medieve dhe organizata që janë OJF, të cilat financohen, marrin para dhe nuk kanë lidhje direkt me medien, por i monitorojnë mediet dhe gjithçka që lidhet me to. Gjithashtu, kemi ftuar grupe të tjera interesi, përveç AMA-s dhe AKEP-it, si dhe trupën akademike, sidomos atje ku ka fakultete të gazetarisë dhe të komunikimit, kemi ftuar të gjithë ata, edhe me emra të përveçëm që janë hapur kundër, të cilët kanë ardhur dhe kanë formuluar terma të tipit ligj “fashist” apo fjali që nuk janë të denja për një komision. Ne, si përfaqësues të këtij komisioni, kemi treguar seriozitetin dhe përgjegjshmërinë tonë ndaj kësaj çështjeje.

Kam një vërejtje për mënyrën e atyre që kanë punuar në qeveri, që i kanë bërë publike arsyet pse është bërë ky ligj. Këto vërejtje i kam shprehur si në Komisionin e Medies, ashtu edhe në Komisionin e Integritetit, sepse është mjaft e rëndësishme që të ketë informacion dhe ky informacion të përcillet sa më qartë te qytetarët, komuniteti i gazetarëve dhe gjithë të tjerët. Po jua përsëris edhe një herë vërejtjen, sepse ka një ndryshim mes asaj që dëgjuam nga ministrja e Drejtësisë, mbledhjet që janë bërë në Komisionin e Integritetit, drejtoresha Juridike e

Kryeministrisë dhe ministrja që mbulon parlamentin, krahasuar me shpjegimet që u dhanë në seancën e parë, përsëri në kontekstin e asaj që për këtë çështje ka një angazhim shumë serioz. A kemi bërë diçka që është vetëm model shqiptar? Në mënyrë absolute, pasi jemi në trendin e gjithë shqetësimeve që ka bota për mënyrën se si informohet sot publiku. Çfarë po rregullojmë, medien e shkruar? Jo, kjo nuk është e vërtetë. Kemi një ligj, të cilin nuk e ka askush në Europë sa i takon medias së shkruar, me tre nene, në të cilat thuhet: “Shtypi është i lirë. Liria shtypit garantohej me ligj. Ligji hyn në fuqi menjëherë”, të cilin e kemi miratuar në shtatorin e largët të vitit 1997.

A jemi duke rregulluar mediet elektronike, televizionet dhe radion? Jo, sepse kemi një ligj që e kemi miratuar me konsensusin e të gjitha palëve politike, por edhe të ndërkombëtarëve. Çfarë po rregullojmë? Po rregullojmë një dukuri të re që ka lindur në Shqipëri, Europë dhe në botë, portalet. Nuk po rregullojmë *Facebook*-un dhe të drejtën e qytetarëve për të komunikuar dhe për t’u bërë secili prej tyre gazetar, por publikimet elektronike. Publikimet elektronike jemi duke i rregulluar, këtu nuk dua të bie ndesh as me qeverinë dhe as me ata që kundërshtojnë, por nuk mund të zhbëj diçka që ka fituar të drejtën e qytetarisë, sepse ky nuk është një ligj kundër *fake news*-it, por është një ligj që do të rregullojë një sektor të parregulluar, siç janë portalet.

Në çfarë mënyrë përpiqet ta rregullojë? Kërkon Edi Rama ta vendosë këtë sektor nën kontroll? Edhe sikur ai të dojë, nuk e bën dot, për shkak të mënyrës se si ky sektor funksionon dhe nuk ka arsye pse ta bëjë. As ai, as qeveria dhe as ne nuk jemi në këtë trend. Ka një shqetësim, pasi në Amerikë mendohet që për shkak të mënyrës se si funksionon ky sektor, është devijuar vullneti i zgjedhësve në shtetin më demokratik të planetit, duke prodhuar një president për të cilin sot po bëhet një gjykim historik në SHBA. Në Bashkimin Europian për këtë çështje janë ndryshuar direktivat, sepse është një fuqi e madhe. Në Shqipëri mendohet që janë 700 portale ose më shumë, askush nuk e di shifrën e saktë. Në Bashkimin Europian po ndryshojnë direktivat dhe në shtete si Gjermania, Franca, Lituania, Kroacia e të tjera po përpiqen ta rregullojnë këtë çështje, jo duke u mbyllur gojën gazetarëve dhe duke vendosur nën kontroll këtë sektor, por duke bërë rregullime, sepse janë një fuqi e madhe. Sot janë 20 gazeta që i lexojnë nuk e di se sa veta, televizione janë 120, por duhet të shkosh të ulesh të presësh lajme, pavarësisht se ka televizione që i transmetojnë lajmet *online*, kurse celular kanë të gjithë shqiptarët dhe ata mund t’i ndjekin lajmet direkt nga aty.

Ne e patëm rastin të shohim se çfarë fuqie pati ky sektor i parregulluar kur keqpërdoret, ku 100 mijë shqiptarë apo 200 mijë dolën në mes të natës nën një terror të pashembullt dhe ende ka me mijëra shqiptarë që e vuajnë atë traumë. Nuk kam parë asnjë përfaqësues të medias, asnjë

gazetar që mbulon të drejtat e gazetarëve, asnjë OJF të dilte dhe të bënte një deklaratë duke e dënuar këtë akt. Përse qeveria nuk mori masa në këtë rast? Për një arsye shumë të thjeshtë, pasi ky sektor është ende i parregulluar. Si mund të marrësh masa në këtë rast, kur ky sektor nuk është rregulluar me ligj?! Ne nuk po e bëjmë për këtë arsye, por jemi të detyruar të marrim në konsideratë shqetësimin që kanë zgjedhësit tanë. Çfarë përfaqësojnë ata që vijnë dhe flasin këtu? Ata përfaqësojnë portalet e tyre, veten e tyre si individë. Natyrisht, janë njerëz shumë të nderuar, por ne jemi diçka më tepër se ata, sepse jemi votuar dhe përfaqësojmë qytetarët, dhe si të tillë jemi të detyruar të marrim në konsideratë shqetësimet e tyre, duke marrë parasysh edhe riskun, sepse fuqia e meideve është e madhe. Mediet të vënë në tabelë, të denigrojnë, të sulmojnë e shumë gjëra të tjera.

Ne nuk jemi këtu për të mbrojtur Edi Ramën dhe as zotërinjtë ministra, por, në radhë të parë, mbrojmë diçka që është jashtëzakonisht e rëndësishme për pluralizmin, vetë pluralizmin. Nëse nuk e dimë se kush i financon portalet, atëherë rreziku i përqendrimit të këtyre portaleve, i mbulimit të 100 portaleve nga një individ apo një kompani është një rrezik shumë i madh, prandaj edhe BE-ja po e adreson këtë çështje. E para.

E dyta, kolegë, jemi duke mbrojtur transparencën në këtë sektor jetik. Nga vijnë këto para? Kush i financon këto portale, Edi Rama, Ilir Meta, Lulzim Basha, partitë politike, biznese të fuqishme private, që në luftë të pandershme sulmojnë njëri-tjetrin? Janë para të krimit, të pista, që vijnë nga fondacione ekstremiste islamike? Janë para që vijnë dhe që duan të ketë destabilitet në Ballkan? Janë 800 portale, kush i financon ato?

Çfarë po kërkojmë ne? Ne po kërkojmë që ato të regjistrohen dhe të bëhet e qartë se kush janë pronarët e tyre. Ne po kërkojmë që AMA çdo vit, ashtu siç bën për televizionet dhe për radion, të bëjë edhe për këto portale, ku secili prej tyre të paraqesë në fund të 3-mujorit të parë një raport se nga kanë ardhur paratë, sa para kanë ardhur dhe se si janë shpenzuar. Ku është krimi këtu?! Ku është mbrojtja e Edi Ramës këtu?! Ne po bëjmë diçka që duhet ta kishim bërë më shpejt, e cila ka të bëjë me thelbin e demokracisë, duke mbrojtur vetë gazetarët. Sa gazetarë punojnë në të zezë? Ata janë të pasiguruar, pasi pronarët nuk u paguajnë as sigurimet shëndetësore dhe as ato shoqërore, sepse janë të paregjistruar.

Çfarë po bëjmë tjetër ne? Ne po kërkojmë që të respektohen të drejtat e autorit, një nga problemet më të mëdha, zonja ministre e di shumë mirë, sepse është një nga dhimbjet e mëdha të kokës kur shkojmë në Bruksel dhe diskutojmë standardet, prandaj po vendosim rregulla që të

respektohen. Do të thoni ju që ka mekanizma të tjerë që e marrin përsipër këtë gjë. Pa diskutim! Por ku duhet të shkojmë e të trokasim dhe t'i gjejmë ato, ndërsa ky regjistrim e garanton këtë gjë. E drejta e autorit është një standard i Bashkimit Europian prandaj duhet ta respektojmë. Jemi duke mbrojtur Edi Ramën apo të drejtën e autorit? Ky është një problem shumë i madh dhe për këtë duhet të ngrihen në protestë të gjithë ata këngëtarë, artistë, regjisorë, të gjithë që kanë bërë libra, poezi dhe filma dhe të thonë: “si është e mundur të ndodhë kjo?!”. Pikërisht këtë jemi duke mbrojtur ne, pasi portalet me fuqinë e madhe që kanë, i përdorin këto gjëra. Pra, ne jemi duke vendosur një rregull dhe jo diktat, dhe as nuk po i mbyllim gojën ndokujt. Si qenka e gabuar nëse kërkojmë mbrojtjen e privatësisë?! Mbrojta e privatësisë është një arritje e madhe; jo privatësia e politikanëve, por e qytetarëve shqiptarë. Sa qytetarë shqiptarë, sa vajza të reja janë cenuar nga këto portale dhe si mund të gjejnë ato ndonjë rrugë për të bërë përgënjeshttrim? Pra, duke mos pasur mënyra që të ruajnë privatësinë, si rezultat i prekjes së të cilës krijohen drama të mëdha, marrin rrugën dhe largohen nga vendi. Pikërisht këtë kërkojmë ne: mbrojtjen e privatësisë.

Është e drejta e çdo qytetari që kur diçka i cenon dinjitetin, ta mbrojë atë. Këtu futet AMA dhe Këshilli i Ankesave, prandaj po përpiqemi ta zgjidhim pa shkuar te konflikti, as te koburja dhe as te gjyqi, por duke shkuar atje dhe duke thënë që kjo nuk është e saktë. Nëse ai që publikon portalin thotë që unë kam fakte, atëherë ligji ia garanton të drejtën të mos e publikojë se ku e ka gjetur faktin, duke mbrojtur gazetarin në këtë rast. Nëse problemi nuk zgjidhet tek AMA, shkohet te Këshilli i Ankesave dhe nëse nuk zgjidhet as këtu, atëherë shkohet në gjykatë. Kush e ka hequr gjykatën?!

A ka vend për modalitete? Po, ka vend, sepse e kemi rregulluar dhe saktësuar çështjen e gjykatës. Si mund të thuhet këtu që gjykata në Shqipëri nuk ekziston dhe gjykatë bëhet AMA dhe, më pas, AMA, sipas atyre që e kundërshtojnë, qenka një organizatë politike?! Nëse Mark Marku dhe Partia Demokratike mburren me këtë ligj, atëherë ai ligj rregullon edhe AMA-n, sepse e kemi bërë me konsensus. AMA, në mënyrën se si zgjidhet, është një organizatë e mbrojtur nga politika, sepse nuk mund të jesh anëtar i saj, nëse je anëtar partie, nëse ke qenë deputet para 8 vjetësh, nëse 3 vjetët e fundit ke qenë anëtar kabineti apo prefekt, nëse ke pasur probleme dhe lidhje me mediet elektronike dhe nuk mund të shkosh, siç bën Mark Marku me shokë, të mbash fjalime politike. Ata duhet të ikin nga AMA.

Ne këtu, si komision, i zgjedhim ata duke përcaktuar edhe fushat...

Milva Ekonomi – Po të jesh anëtar i bordit të AMA-s, nuk duhet të vish këtu e të mbash fjalime.

Musa Ulqini – Sapo e thashë këtë, duke përmendur Mark Markun.

...nga vijnë gazetaria, OJQ-të, institute, sektori akademik, nga të gjitha fushat që nuk kanë lidhje me politikën dhe nuk kanë konflikt interesi. Ne po bëjmë diçka shumë të mirë dhe për këtë jam i detyruar t’ju përmend diçka dhe t’ju garantoj, kërkoj ndjesë dhe besoj se askush nuk do të më keqkuptojë, që një problem të tillë, personalisht e kam përjetuar këtë gjë në komision dhe në seancë plenare, kur kam qenë kryetar i këtij komisioni në vitin 1998, kur kemi rregulluar ligjin “Për mediet e elektronike”. Nuk mund ta imagjinoni se çfarë sulmi në emër të përveçëm kam përballuar. A e dini se çfarë thuhej atëherë, se tani gjërat kanë ndryshuar? Atëherë thuhej: “këto janë paratë e mia dhe se si e bëj lajmin në televizionin tim privat, kjo është puna ime!”. Jo more, se ke lekë mund të prodhosh një akullorë, por nuk mund ta dëmtosh shëndetin e fëmijës dhe as të qytetarit; e njëjta gjë është edhe për medien, e cila është një e mirë e madhe publike. Ti mund t’i kesh paratë, por kur ke television, je i detyruar të respektosh standardet, sepse frekuencat janë pasuri kombëtare dhe patjetër duhet t’i respektosh ato. Ashtu siç respektohet shëndeti nga një akullorë, ashtu duhet të respektohet edhe nga lajmi.

Ja ku jemi sot në vështirësi të mëdha. Ai zotëria që është atje mund ta dëshmojë faktin se sa sulme dhe sa kundërsulme ka pasur, duke thënë se këtë e ka qeveria, prandaj jemi në këtë situatë, duke pasur një sektor të rregulluar, në të cilin futen edhe mediet kabllorë, të cilat më përpara i vidhnin pronarët, duke bërë hapa të mëdhenj dhe sot jemi këtu që jemi. Kemi një transmetues që ka qenë një *portavoçe* e qeverisë, një transmetues publik, të cilin e kemi rregulluar me këtë ligj, por me shumë vështirësi. Atëherë kemi marrë në konsideratë shumë propozime, por edhe tani, në të kundërt, nuk do të kishim bërë kaq shumë mbledhje dhe debate.

Në mbyllje, dua t’ju them se 2-3 çështje që janë diskutuar edhe në Komisionin e Ligjeve, mendoj se duhet të qartësohen dhe të rregullohen. Gjërat që janë rregulluar, i kemi tashmë, por është më mirë t’i themi, pasi njerëzit nuk kanë informacionin e duhur. Ky është një shqetësim publik i madh, që haset në Shqipëri, i cili diskutohet në Amerikë dhe në BE, duke marrë në konsideratë edhe direktivat e BE-së dhe standardet më të mira të shteteve që janë duke i bërë këto rregullime. Është në vullnetin e qeverisë për t’i përmirësuar, rregulluar dhe për të bërë gjënë më të mirë të mundshme. Deklarata të tilla, si ato të kryetares së komisionit apo deklarata të tilla, siç dëgjova sot nga Partia Demokratike, përfaqësuesit e të cilës ishin shprehur se “u bë”, më duket

“ligji i 300-të”, se sapo të vinin në pushtet ditën e parë do t’i shfuqizonin, këto janë çështje që kërkojnë një përgjegjshmëri dhe përkushtim të madh.

Ndoshta dikush këtu, si përfaqësues i qeverisë, mund t’i shpjegojë publikut ato 2-3 gjëra që keqpërdoren edhe nga mediet e huaja, sepse nuk ka informacion, që lidhen me debatet me OSBE-në, të na qartësohen më shumë, pasi mjafton vullneti i mirë për t’i bërë.

Zonja kryetare, ne kemi futur parimin e proporcionalitetit, i cili është mjaft i rëndësishëm. Pse është i rëndësishëm? Është i rëndësishëm, pasi AMA do ta ketë parasysh, sepse nuk është një lloj një televizion kombëtar me një portal që ka 5 veta të punësuar.

Ju kërkoj ndjesë që u zgjata kaq shumë në diskutimin tim, por e bëra për 2 arsye, duke lënë modestinë si relator, por më shumë në respekt të historisë se çfarë ka ndodhur në këtë komision, sa herë që kemi diskutuar rregullimet në fushën e medias. Kjo ndodh për arsye se media ka një specifikë të veçantë, që nuk e kanë sektorët e tjerë, duke përdorur profesionin që kanë, për të bërë publicitet, dhe kjo është diçka e mirë.

Sot portalet i kanë dhënë një fuqi të madhe qytetarit dhe qeveria nuk është kundër kësaj. Portalet janë një arritje shumë e madhe e teknologjisë, duke e bërë demokracinë akoma më të mirë, informimin më të fuqishëm dhe të larmishëm, por kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për rregullime, të cilat veçse i japin fuqi informimit, gazetarëve dhe gjithçkaje demokratike se si funksionon media.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Ulqini!

Dua të shtoj diçka, para se të fillojmë me miratimin në parim. Në fakt, komisioni ynë, besoj se ju kujtohet kolegë, ka punuar me komente të shkruara, të cilat kanë ardhur nga zyrat e OSBE-së, BE-së, Këshillit të Europës, si dhe letrën që ka ardhur nga Komisioneri i Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, në punën tonë ne jemi bazuar në rezolutën e Komisionit European kundër Diskriminimit dhe Racizmit, sidomos në nenet 7 dhe 15, që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe mbrojtjen e fëmijëve nga pornografia. Keni parasysh që tri objektivat kryesore të mbrojtjes së publikut: pornografia kundër fëmijëve, siguria kombëtare dhe terrorizmi, janë pjesë që janë marrë në konsideratë edhe nga komisioni, gjatë punës së tij.

Gjithashtu, në *e-mail*-in tuaj kanë ardhur informacione lidhur me statusin e përkthimit të dokumenteve, mënyrën se si janë reflektuar ato në ligje.

Unë dua të përfitoj nga ky moment për të falënderuar edhe Komisionin e Ligjeve që të premten ka shpenzuar të gjithë ditën me komisionin tonë, për të integruar në ligjin e depozituar nga Këshilli i Ministrave të gjitha komentet që janë bërë nga organizatat ndërkombëtare.

Dua t'ju them, gjithashtu, se në sekretarinë e komisionit tonë janë depozituar me shkrim edhe komente nga profesorati, sidomos nga ai i Drejtësisë, të cilat janë marrë në konsideratë. Puna ka qenë e pandalshme, për ta përmirësuar. Dhe varianti që kemi këtu e ka marrë në konsideratë këtë gjë: që frekuenca është pasuri kombëtare, si dhe e kemi marrë në konsideratë gjithmonë që individi duhet të mbrohet, sipas të gjitha rezolutave ndërkombëtare. Fjala e lirë është shumë e rëndësishme dhe ne, në komision, duhet të kemi detyrën për ta mbrojtur fjalën e lirë. Për këtë arsye kërkojmë nga AMA dhe të gjitha shoqatat e gazetarëve që parimet e rëndësishme, siç janë: parimi i etikës profesionale, të shtypit, parimi i unifikimit të të drejtave të gazetarëve, duhet të jenë parime drejtuese në punën e gazetarëve.

Kur kemi bërë ndryshime në këtë ligj, një nga gjërat më të rëndësishme për ne ka qenë parimi i vetërregullimit, për të cilin kemi bërë diskutime.

Unë mendoj që projektligjin ta hedhim në votim në parim. Kush është dakord me këtë projektligj në parim? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Ftoj pranë meje pjesën e sekretariatit të komisionit, zotin Gazmend Bici. Gjithashtu, kemi të ftuar zonjën Vasilika Hysi, si anëtare e Komisionit të Ligjeve, e cila ka qenë bashkë me ne në këtë diskutim për përmirësimin nen për nen të projektligjit. Në “paketën antishpifje” dhe që nuk është fare antishpifje, por kështu ka marrë emrin, ka dy projektligje.

Mbyllet pika e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 17:40

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – Zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Miratimi në parim, nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar”"

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Ramazan Gjyzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Klajdi Qama, Besnik Baraj (zëvendësues) dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Fatjona Dhimitri, Enada Kapllani, Amra Barova, Erion Piciri.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë,

Besmir Beja – drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë,

Irena Malolli - drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Enea Karakaçi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Gentian Sala – Kryetar i AMA-s,

Sara Xhumbari- drejtore juridike e AMA-s,

Jetmir Braha – përfaqësues i AKEP-it,

Elira Kokona – përfaqësuese e Zyrës Juridike të Këshillit të Ministrave,

Si vëzhgues:

Ermira Zharri – përfaqësuese e OSBE-së,

Enisa Karanxha – përfaqësuese e Zyrës së Këshillit të Europës.

Hapet pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Meqenëse projektligjin për amendimet në ligjin “Për komunikimet audiovizuale në Republikën e Shqipërisë” e kaluam në parim, projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, a jemi dakord që ta kalojmë në parim? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Edhe për këtë projektligj kemi bërë diskutime, sepse kuptohet që në këtë projektligj reflektohen ndryshimet që kalojnë në ligjin për mediet audiovizive dhe ndryshimet vijnë si pasojë e saj.

A jeni dakord me nenin 1? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

A jeni dakord me nenin 2? Kundër? Abstenime?

Miratohet

A jeni dakord me nenin 3? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

A jeni dakord me nenin 4? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

A jeni dakord me nenin 5? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

A jeni dakord me nenin 6? Kundër? Abstenime?

Miratohet

Kalojmë në miratimin në tërësi të projektligjit: “Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Faleminderit!

Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 17:50

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – Zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

3.Diskutimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Ramazan Gjyzi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Klajdi Qama, Besnik Baraj (zëvendësues) dhe Vasilika Hysi.

Mungojnë:

Fatjona Dhimitri, Enada Kapllani, Amra Barova, Erion Piciri.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë,

Besmir Beja – drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë,

Irena Malolli - drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Enea Karakaçi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Gentian Sala – Kryetar i AMA-s,

Sara Xhumbari- drejtore juridike e AMA-s,

Jetmir Braha – përfaqësues i AKEP-it,

Elira Kokona – përfaqësuese e Zyrës Juridike të Këshillit të Ministrave,

Si vëzhgues:

Ermira Zharri – përfaqësuese e OSBE-së,

Enisa Karanxha – përfaqësuese e Zyrës së Këshillit të Europës.

Hapet pika e tretë e rendit të ditës

Diskutimi dhe miratimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shitesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”

Milva Ekonomi - Kalojmë në miratimin nen për nen të projektligjit “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Të gjithë keni para një tabelë, e cila ka dy kolona, në kolonën e parë është projektligji i depozituar nga Këshilli i Ministrave dhe në kolonën e dytë është projektligji i ripunuar, pas propozimeve që kanë ardhur nga OSBE-ja, BE-ja, Këshilli i Europës, nga profesori dhe diskutimet që janë bërë në Komisionin e Ligjeve. Kemi pasur, gjithashtu, asistencë në këto ndryshime nga ekspertë që kanë ardhur nga Këshilli i Ministrave.

Neni 1 ndryshon. “Titulli i ligjit ndryshon si më poshtë vijon: Për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë”. Kush është dakord të votohet siç është, pra me ndryshimet? Mbani parasysh kolonën 2 të tabelës. Do të lexojmë tabelën 2. Është ligji i ndryshuar sipas ripunimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve. Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 2 nuk ka ndryshime nga varianti i Këshillit të Ministrave. Kush është dakord? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 3. Po ta shikoni, ndryshimi dhe një propozim që ka ardhur nga grupi i punës, janë me bold. Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe shërbimet e publikimeve elektronike. Ky ligj nuk zbatohet për medien e shkruar. Kush është dakord? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 4. Në nenin 3 bëhen këto ndryshime: “1. Në pikën 3 emërtimi “Autoriteti i Medies Audiovizive” zëvendësohet me “Autoriteti i Medieve Shqiptare”. 2. Pas pikës, 17/2 shtohet pika

17/3 me këtë përmbajtje: “Ofruesi i Shërbimeve të Publikimeve Elektronike (OSHPE) është personi fizik ose juridik, pavarësisht nëse është regjistruar ose jo si i tillë në regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Medietike, i cili ofron shërbimet e publikimeve elektronike, siç janë përcaktuar në pikën 26/1 të këtij neni. Pika 22 ndryshon si më poshtë vijon: “Përgjegjësi editoriale nënkupton: a) ushtrimin e kontrollit efektiv si për përzgjedhjen e programeve dhe për organizimin e tyre në një listë dhe orar, në rastin e shërbimeve të transmetimeve të drejtpërdrejta audiovizive; b) një katalog në rastin e shërbimeve të programit audioviziv sipas kërkesës; c) një publikim me rastin e publikimeve elektronike”. Pika 23 e publikimeve e elektronike e shikoni që është bërë me bold dhe është propozimi i grupit të ekspertëve. Pika 23 ndryshon si më poshtë vijon: “Prodhime të pavarura nënkuptojnë aktivitetin e prodhimit të veprave mediatike, të cilat plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme: a, kur nuk janë të kontrolluara ose të lidhura me transmetuesit me licencë ose me autorizim për transmetimin ose me ofruesit e shërbimeve të regjistruara në regjistrin e ofruesve të shërbimeve medietike; b, kur për një periudhë prej tre vjetësh të paktën 90% e këtyre prodhimeve nuk janë të destinuara për një transmetues të vetëm.”

5. Pika 24 ndryshon si më poshtë vijon: “Prodhuesi i pavarur është personi fizik a juridik i regjistruar për prodhimin e veprave dhe veprave audiovizive me vendndodhje në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar të Bashkimit Europian, ose në ndonjë vend tjetër, që është nënshkrues i një marrëveshjeje ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim për Republikën e Shqipërisë, që nuk është i lidhur me një ofrues të shërbimit të medias pjesëmarrës në treg, në kuptim të ligjit që rregullon mbrojtjen e konkurrencës”.

“24/1. Prodhim personal është një program ose publikim që është i prodhuar për herë të parë nga ofruesi i shërbimit të medias ose një person tjetër në drejtim dhe në emër të ofruesit të shërbimit të medias.”

“24/2. Bashkëprodhim është një prodhim ose publikim i përbashkët i ofruesve të shërbimeve mediatike ose ofruesit të shërbimit mediatik dhe një prodhuesi të pavarur.”

6. Pas pikës 26, shtohen pika 26/1 dhe 26/2 me këtë përmbajtje: “26/1 Publikimi elektronik nënkupton faqe interneti me përmbajtje të formësuar editoriale dhe /ose portale që përmbajnë versione elektronike të medias së shkruar dhe/ ose informacione medietike të ofruara për publikun, me qëllim argëtimin, informimin dhe edukimin. Publikimet elektronike të bëra nga individët, të cilët nuk kanë përmbajtje të formësuar editoriale dhe nuk kanë qëllim edukimin, argëtimin dhe informimin e publikut, nuk konsiderohen publikime elektronike në kuptimin e këtij ligji.”

“26/2. Media elektronike është program ose përmbajtje programi audio dhe audioviziv ofruar për publikun nëpërmjet medieve elektronike të komunikimit dhe përmbajtjen e publikimeve elektronike.”

7. Pas pikës 53, shtohen pikat 54 dhe 55 me këtë përmbajtje: “54. Regjistri i ofruesve të shërbimeve mediatike është një regjistër kombëtar, ku regjistrohen ofruesit e shërbimeve audio, audiovizive dhe ofruesit e shërbimeve elektronike.”.

“55. Përmbajtja e programit janë informacionet, idetë, shprehjet e mendimeve, si edhe vepra të autorësisë në formë audio, në vijim referuar si përmbajtje audio, ose në formën e imazheve të lëvizshme me ose pa tinguj në vijim, referuar si përmbajtje audiovizive që përbën një element individual brenda një liste a katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, i cili bëhet i disponueshëm për publikun përmes medieve elektronike, me qëllim për të informuar, argëtuar, edukuar”.

Musa Ulqini – Më falni, por është e nevojshme që në nenin 4, te pika e 2- të, 17/1-shi, aty ku thuhet: “Në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike”, duhet rregulluar: “në regjistrin e ofruesve të shërbimeve të medias elektronike”, sepse duhet respektuar neni 18, pasi kështu është saktësuar në nenin 18. Kjo është edhe në respekt të qëllimit të projektligjit dhe fushës së veprimit, që janë nenet 2 dhe 3. Pra, nenet 2, 3, 18 dhe të gjitha rregullimet që janë bërë dhe që janë me bold, e kërkojnë këtë rregullim.

Milva Ekonomi - A ka ndonjë opinion nga hartuesit?

Elira Kokona – Po. Në parim jam dakord me deputetin, por duhet të mbajmë parasysh se kemi dhënë një përkufizim në pikën 55 tuajën, ku thuhet: “Regjistri i ofruesit të shërbimeve mediatike” dhe në këtë përkufizim është evidente që u referohemi shërbimeve audioaudiovizuale dhe ofruesit të shërbimeve elektronike. Kështu që përmbajtja e asaj që ju thoni, në fakt, përkon me përkufizimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, neni 18 i referohet konceptit të ofruesit të shërbimit mediatik dhe nuk i referohet ofruesit të shërbimit mediatik të gazetarisë së shtypur. Nëse do të ndryshohet, duhet të ndryshohet kudo edhe përkufizimi.

A mund të kthehem pak te neni 3?

Ju përmendët shtesën që ky ligj nuk zbatohet në medien e shkruar. Në fakt, është në medien e shtypur, sepse edhe media online është e shkruar në mediumin online.

Milva Ekonomi- Kjo që kemi vendosur këtu është pjesë e ligjit në fuqi.

Elira Kokona - Duhet të thuhet “Media e shkruar në kuptim të ligjit specifik”, sepse po të thuhet “Media e shkruar”, ajo në kuptim të këtij ligji ka një specifikë, ka një nen, ku përcaktohet çfarë është media e shkruar në kuptim të këtij ligji.

Mirela Kumbaro - Kur ju thoni “media e shtypur” keni parasysh përkthimin literal të printit media, që, në fakt, në gjuhën shqipe është fjala për shtypin e shkruar? Po fusim një term që nuk përdoret sot, me gjithë përkthimet e drejtpërdrejta nga gjuhët e huaja. Unë mendoj se duhet thënë “media” ose “shtypi i shkruar”, në kuptimin e këtij ligji. “Media e shtypur” është një togfjalësh që nuk ka hyrë ende në gjuhën shqipe si i tillë.

Musa Ulqini - Si pjesë e grupit të punës, unë them se ne e kemi shtuar këtë. U dha një shpjegim shumë i mirë, por ne jemi nisur nga ligji në fuqi. Në nenin 2, “Fusha e zbatimit”, thuhet se ky ligj nuk zbatohet për medien e shkruar me idenë që ne po përpiqemi ta cenojmë shumë pak ligjin në fjalë, që është miratuar me konsensus nga të gjithë. E bëmë këtë edhe për të larguar atë lloj perceptimi që e kishin ata që e kundërshtojnë, që duan të shtojnë numrin e aleatëve në luftën kundër projektit, që ky ligj cenon edhe medien e shkruar, që nuk është e vërtetë. Për të qenë korrekt e kemi marrë *mot a mot*, për të shmangur këtë gjë. Kemi qenë ne të dy që e kemi propozuar, prandaj ju sqarova.

Elira Kokona – Unë jam shumë dakord me përmbajtjen, në kuptim të këtij ligji, është neni 31, i cili duhet të ndryshohet me këtë logjikë. Pra, nëse themi “media e shkruar” në kuptim të ligjit të cilit ju i referoheni, do të ishte më korrekte ligjërisht dhe të njëjtin ndryshim duhet të bëjmë edhe në nenin 31. Pra, është media e shkruar në kuptimin e ligjit specifik.

Milva Ekonomi- Do të merret sekretaria me këto rregullime, sepse janë teknike legjislative.

Kush është dakord me nenin 4, pas sqarimeve që u bënë, pra që të mbetet siç është? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 5. Në nenin 4 bëjmë këto ndryshime: “Titulli i nenit 4 të ndryshohet si më poshtë vijon: Parimet themelore të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve mediatike.”.

2. Në pikën 2 të nenit 4 fjala “audiovizive”, zëvendësohet me fjalën “të medias elektronike”.

Kush është dakord me këto ndryshime? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 6. Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje: “neni 4/1. Interpretimi i ligjit. Dispozitat e këtij ligji nuk duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që të japin të drejtën për të censuruar ose kufizuar të drejtën për lirinë e fjalës ose lirinë e shprehjes”.

2 . Ky ligj interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, sikurse zbatohet në praktikatat ligjore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nga Komisioni i Ligjeve ka ardhur propozimi që fjala “duhet” të bëhet “ mund”. A jeni dakord të marrim në konsideratë opinionin që ka sjellë Komisioni i Ligjeve? Kush është dakord me këto ndryshime? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 7. “Titulli i kreut të dytë ndryshohet si poshtë vijon: Autoriteti i Medieve Shqiptare (AMA) ...

Po.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Unë dua të sqaroj një çështje, për të cilën me të drejtë kolegu reagoi pse është ndërruar titulli i Autoritetit nga “Autoriteti Shqiptar i Medies” në “Autoriteti i Medies Shqiptare” dhe akronimi nuk ka ndryshuar? Kemi diskutuar në Komisionin e Ligjeve dhe ndryshimi i emërimit të autoritetit është bërë me propozim të ekspertëve të OSBE –së, sepse flasim për autoritet shqiptar të medieve shqiptare dhe aktualisht te ligji, siç është, duket sikur është për të gjitha mediet, edhe për mediet jo shqiptare, por kur erdhi fjala për të ndryshuar akronimin, kjo të krijon problem për AMA-n, e cila është e njohur ndërkombëtarisht si AMA. Pra, reagimi juaj është më se i drejtë, por kjo është diskutuar gjerësisht edhe në prani të përfaqësuesve të AMA-s.

Musa Ulqini- Meqenëse ne akuzohemi se nuk kemi marrë në konsideratë se çfarë ka thënë OSBE-ja, ju garantoj se ky është një nga rastet kur ne kemi respektuar saktësisht atë që ka propozuar OSBE-ja, e cila ka pasur këto argumente që u thanë këtu.

Milva Ekonomi – A jeni dakord? Kush është kundër?

Miratohet.

Neni 8. Në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

“Pika 1 ndryshohet si poshtë vijon: “AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimit të transmetimeve audio dhe audiovizive, shërbime të tjera mbështetëse të tyre, si dhe shërbime elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Pika 2: “Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “4. Organet vendimmarrëse të AMA-s janë Bordi dhe Këshilli i Ankesave”.

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Kudo në tekstin e këtij ligji bëhen këto ndryshime:

“1. Fjalët “Kryetari i AMA-s” dhe “Kryetarit të AMA-s” zëvendësohen me fjalët “Kryetari i Bordit të AMA-s” dhe “Kryetarit të Bordit të AMA-s”.

2. Fjalët “Zëvendëskryetari i AMA-s” zëvendësohen me fjalët “Zëvendëskryetari i Bordit të AMA-s”.

3. Fjalët “anëtarët e AMA-s” dhe “anëtari i AMA-s” zëvendësohen me fjalët “anëtarët e Bordit të AMA-s” dhe “ anëtari i Bordit të AMA-s”.

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

“1. Titulli i nenit 8 ndryshohet si më poshtë vijon: “Përbërja e Bordit të AMA-s.”

Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

“1. Titulli i nenit 9 ndryshohet si më poshtë vijon: “Zgjedhja e anëtarëve të bordit të AMA-s”.

2. Në nenin 9, kudo në tekst, para fjalëve “AMA-s”, të vendosen fjalët “Bordit të...” .

Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

“1. Titulli i nenit 13 ndryshohet, si më poshtë vijon: “Kuorumi dhe vendimmarrja e Bordit të AMA-s” .

2. Në nenin 13, kudo në tekst, fjalët “...mbledhjet e AMA-s” dhe “vendimet e AMA-s zëvendësohen me fjalët “mbledhjet e Bordit të AMA-s” dhe “vendimet e Bordit të AMA-s”.”

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Ismet Beqiraj - Unë do të sugjeroja që për çdo dispozitë, për të cilat janë marrë në konsideratë edhe rekomandimet nga OSBE-ja, KE-ja, BE-ja e të tjerë, të thuhet: “Të gjitha këto nene janë rekomandime të OSBE-së”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, e di që të gjithë jemi të lodhur, por të gjithë qytetarët shqiptarë, bashkëpunëtorët dhe miqtë tanë ndërkombëtarë, duhet ta marrin vesh që ne i kemi marrë në konsideratë të gjitha propozimet e tyre. Unë i kam të gjitha këtu para, i kam nënvizuar dhe i kam të qarta, por duhet t'i marrin vesh edhe ata.

Milva Ekonomi – Në rregull!

Faleminderit!

Për t'ju sqaruar: nga neni 7 e më tej të gjitha propozimet vijnë si nga grupi i punës, ashtu edhe nga ekspertët e OSBE-së.

Vazhdojmë me nenin 13, ku kemi propozimin e ekspertëve të OSBE-së, që kanë sjellë ndryshimin e këtij neni.

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

“1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa: a) Në shkronjën “a”, fjala “audiovizive” zëvendësohet me fjalët “medietike”, të cilat janë në fushën e veprimit të këtij ligji”.

b) Në shkronjën “c”, pas fjalës “shërbimeve” shtohen fjalët “..medietike, të cilat janë në fushën e veprimit të këtij ligji”.

2. Në pikën 2 bëhen shtesat, me këtë përmbajtje: a) Në shkronjën “a”, pas fjalës “programeve” shtohen fjalët “dhe publikimeve”.

b) Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje: “e) nxitjen e përmbajtjes së përgjegjshme në publikimet elektronike dhe nxitjen e zbatimit të një kodi etike ndërmjet operatorëve dhe ofruesve të këtyre shërbimeve në këtë drejtim.”.

Kush është dakord me ndryshimet e nenit 13? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. Edhe ky nen është propozim që vjen nga grupi i punës, pasi është konsultuar edhe me Kodin e Etikës.

“Në nenin 19 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon: 1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme: a) Shkronja “h” ndryshohet, si më poshtë vijon: “h) zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik dhe mosmarrëveshjet ndërmjet subjekteve fizike/juridike dhe ofruesve të shërbimeve medietike;”.

b) Shkronja “j” ndryshohet, si më poshtë vijon: “j) bashkëpunimi dhe këshillimi me Autoritetin Kombëtar të Certifikimeve Elektronike dhe Sigurinë Kompjuterike (AKCESK), AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, Autoritetin përgjegjës për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoritetin përgjegjës për Mbrojtjen e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoritetin përgjegjës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Autoritetin përgjegjës për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, si dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj;”.

c) Pas shkronjës “j” shtohen shkronjat “k” dhe “l” me këtë përmbajtje: “k) miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Ankesave (në vijim referuar si KA), ku përcaktohen rregulla specifike për trajtimin e ankesave të parashtruara pranë KA-së, së bashku me përcaktimin e kriterëve të qarta për zbatueshmërinë e sanksioneve të parashikuara nga ky ligj, me qëllim respektimin e parimit të proporcionalitetit.

l) administron dhe përditëson Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Medietike;”.

2. “Në pikën 2 bëhen këto ndryshime: “a) Në shkronjën “a” fjalët “medieve audiovizive” zëvendësohen me fjalën “transmetimit”.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon: “b) mbikëqyr zhvillimin e veprimtarisë së medias elektronike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;”.

c) Në shkronjën “c”, fjalët “medieve audiovizive” zëvendësohen me fjalët “medies elektronike ”.

ç) Në shkronjën “ç” fjalët “medieve audiovizive” zëvendësohen me “medieve elektronike”.

3.”Pika 3 ndryshon, si më poshtë vijon: “3. AMA mbikëqyr zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e medias elektronike dhe, në rast shkeljesh, vendos sanksione.”

4. “Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon: “8. AMA jep mendim për veprimtarinë e medias elektronike në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë për perspektivën e veprimtarisë së medias audiovizive sipas kërkesës apo kryesisht.”.

5. “Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: “10. AMA merr pjesë në veprimtari ndërkombëtare, në lidhje me strategjinë dhe perspektivat e zhvillimit të medieve audiovizive në veçanti dhe shërbimeve të medias në përgjithësi, duke përfaqësuar Republikën e Shqipërisë dhe mbështet pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e subjekteve publike e private me organizata homologe europiane dhe botërore në fushën e medias. AMA përgatit studime me rekomandime për qëndrimin e Republikës së Shqipërisë në bisedimet ndërkombëtare zyrtare mbi medien.”.

Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 14? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Ky nen është propozim i ekspertëve të OSBE-së, sidomos për ndryshimin e pikës 1.

“Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Këshilli i Ankesave është organ kolegjal vendimmarrës, i cili përzgjidhet nga Bordi i AMA-s me shumicë të cilësuar dhe përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë, specialistë të fushës së medias, të cilët emërohen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë. Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Ankesave, që bazohen në rregullat e konkurueshmërisë dhe rregullorja e organizimit dhe funksionimit të tij, përcaktohen me vendim të Bordit të AMA-s”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon: “2. Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është mbikëqyrja e zbatimit të parashikimeve të këtij ligji, atyre të Kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë me respektimin e dinjitetit dhe të të drejtave themelore të njeriut.”.

3. Në pikën 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime: a) Në shkronjën “a”, pas fjalës “... OSHMA-të...” shtohet “... OSHPE-të ...”.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon: “b) të shqyrtojë ankesat sipas neneve 51, 51/1, 52, 53 dhe 53/1, të këtij ligji.”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje: “3/1. Vendimet e Këshillit të Ankesave, sipas pikës 3/b të këtij neni, ankimohen në Bordin e AMA-s.””

Musa Ulqini – Më falni, por për shkak të nxitimit nuk lexuat fjalën “dhe juristë”, sepse është shumë e rëndësishme.

(Diskutime pa mikrofon)

E keni hequr këtë fjalë, sepse ne këtu e kemi shënuar?

Vasilika Hysi – A mund të bëj një sqarim?

Milva Ekonomi – Patjetër!

Vasilika Hysi – E falënderoj kolegun për ndërhyrjen!

Në fakt, në grupin e punës ku kanë marrë pjesë të gjithë relatorët e komisioneve, bashkë me këshilltarët juridikë të komisioneve, u sugjerua që të jenë edhe juristët me argumentin e vetëm se ka shumë problematika që lidhen me praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kur vjen fjala për raportin ndërmjet nenit 10 të Konventës së Lirisë së Shprehjes dhe protokollit shtesë të Konventës, nenit 14, për mosdiskriminimin, por edhe të çështjeve që lidhen me përmbajtjen. Kishte një reagim nga përfaqësuesit e AMA-s dhe ne e pamë me vend, ndoshta zoti Sala mund ta ritheksojë, që ky është një bord i përbërë nga specialistë të medias, të cilët nuk do të caktohen, pra do të përzgjidhen në bazë të një procedure transparente konkurruese me kritere të forta, ndryshe nga sa janë caktuar sot, për t'i dhënë më shumë pavarësinë, të cilën e kanë merak një pjesë e njerëzve që janë skeptikë për këtë ligj.

Meqenëse në stafin e AMA-s ka mjaftueshëm juristë në departamente të tjera, ne ramë dakord, edhe unë si një bashkërelatore e pranova për ta hequr këtë propozim, të cilin e kemi diskutuar midis nesh në grupin e punës. Unë kam besim, zoti Ulqini, që me vetërregullimet që do të bëjnë mediet, me trajnimet dhe kualifikimet e vazhdueshme që do të bëjnë, gazetarët do të jenë njohës shumë të mirë edhe të praktikës dhe të standardeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Elira Kokona - A mund të theksoj arsyen pse u kërkua një propozim i tillë?

Milva Ekonomi – Patjetër!

Elira Kokona - Këshilli i Ankesave gjithmonë e më shumë do të ketë një rol seleksionues procedural. Pra, më shumë se një organ që vendos në lidhje me përmbajtjen e publikimeve apo në lidhje me thelbin e profesionit të medias, në fakt, do të jetë tipik një organ seleksionues procedural juridik. Kështu që në këtë kontekst kontributi i profesionistëve të së drejtës, pse jo me eksperiencë në fushën e medias, mendoj se do të ishte më i vlefshëm. Pra, kjo është edhe arsyeja pse ne përmendëm që të kishte më shumë se një kategori profesionistësh si anëtarë, pasi kështu do të kombinohej më mirë edhe performanca institucionale sesa thjesht përcaktimi i një profesioni.

Milva Ekonomi – A keni për të shtuar diçka, zoti Sala?

Gentian Sala – Në qoftë se ka një ndarje të thellë të të gjithë diskutimit që po bëjmë ne është ajo e diskutimeve të juristëve që kanë të gjithë pro ligjit me diskutimet e gazetarëve. Këshilli i Ankesave, siç e ka parashikuar ligji, duhet të përbëhet nga gazetarë, të cilat duhet të kenë 10 vjet eksperiencë dhe flitet për çështje thelbësisht të gazetarisë. Administrata e AMA-s është aty gjatë gjithë kohës, ku merren mendime dhe konsultohen; Bordi i AMA-s gjithmonë historikisht ka pasur edhe juristë brenda vetes, pra kur vjen ankesa. Kështu që Këshillin mendoj që t'ua lëmë ekskluzivisht gazetarëve, ashtu siç thotë ligji, me 10 vjet eksperiencë. Juristë te bordi, juristë në administratë, juristë te Këshilli i Ankesave janë shumë. Ky është mendimi ynë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Patjetër, zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Këshilli i Ankesave merr një fuqi shumë të madhe dhe për herë të parë ndeshet me një dukuri, me të cilën nuk është ndeshur deri tani si institucion. Ne, kur e diskutuam, thamë që një jurist atje është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse procedurat janë jashtëzakonisht të rëndësishme, pasi janë gjëra që do të shkojnë deri në Gjykatën e Strasburgut, sipas parashikimeve të mia. Unë kuptoj shumë mirë që AMA ka edhe juristë në administratën e saj, por ka edhe te bordi i saj, por kjo është si violina dhe për këtë po bëhet e gjithë zhurma, pra për Këshillin e Ankesave. Ne nga 3 anëtarë e kemi bërë me 5 anëtarë, ku kemi futur konkurrueshmërinë, pra duhet të shpallet një konkurs dhe atje pa diskutim që duhet të kenë 10 vjet eksperiencë. Për mua është hera e parë që dëgjoj se juristët qenkan dakord që të largohen nga një fushëbetejë, por me logjikë e mbështes përfaqësuesin e Këshillit të Ministrave, sepse është...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Juristi e shikon më ngushtësisht çështjen, pasi shikon ligjin dhe procedurën, lexon Kodin e Procedurës Administrative, ndërkohë që gazetari vjen nga fusha e gazetarisë dhe e ka më të vështirë. Pra, në qoftë se juristët mendojnë ngushtësisht se duhet të vendosin një gjobë, ai që vjen nga bota e gazetarisë e ka më të vështirë që ta vendosë këtë gjobë, pasi, në fund të fundit, këtë njeri e ka të botës së vet, mund të jetë pjesë e Unionit të Gazetarëve, ku janë me qindra vetë apo edhe nga institucione të tjera. Pra, gazetari e ka më të vështirë që t'i vendosë gjobë edhe institucionit të tij, sepse e shikon më shtruar çështjen, të paktën eksperiencia këtë ka treguar, ndërkohë që juristi e ka më të thjeshtë, pasi lexon procedurën, neni kaq, neni aq dhe e vendos gjobën.

(Diskutim e pa mikrofon.)

Musa Ulqini – Përkundrazi, ne cituam se sa ligje sjell ky rregullim në vëmendjen tonë, pasi Këshilli i Ankesave do të kërkojë që t’i mbrojë të gjithë qytetarët pa përjashtim. Pra, se çfarë thotë ligji për privatësinë apo çfarë thotë ligji për diskriminimin, unë mendoj se duhet një jurist që ta shpjegojë, sepse e njeh ligjin, jo një gazetar. Unë mund të numëroj 20 ligje që nuk kanë lidhje në përmbajtje me gazetarinë apo se si bëhet një shkrim, si bëhet një koment, si shkruhet një opinion, pra nuk kanë të bëjnë fare me procedurën. Në gjykimin tuaj, në qoftë se ne do të flasim që juristi duhet për procedurë, unë jam dakord me ju, por nuk është kështu. Janë shumë ligje që duhet të referohen dhe për këtë duhet një jurist që t’i shpjegojë saktësisht edhe Konventën Europiane, si dhe të gjitha konventat dhe të gjitha ligjet e tjera.

Milva Ekonomi – Tani ne kemi nevojë që të diskutojmë këtu, pasi dëgjuam edhe opinionin e tyre. Pra, ejani t’i kthehemi diskutimit dhe të vendosim se duhet të ketë edhe juristë. Pra, komisioni ynë ngul këmbë se duhet të ketë edhe juristë në përbërje, ndërkohë që dëgjoi edhe argumentet e përfaqësuesve nga Këshilli i Ministrave edhe nga AKEP-i.

A jeni dakord që të shtojmë fjalën “edhe juristë”? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, e hedhim në votim nenin 15, me ndryshimin e bërë. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Vazhdojmë me nenin 16, i cili është ndryshuar nga grupi i punës.

“Pas shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit 21 shtohen shkronjat “e” dhe “ë” me këtë përmbajtje: “e) të marrë masa dhe veprime për të nxitur lirinë e medias në përputhje me rregullat dhe detyrimet etike. ë) Të nxisë vetërregullimin e medias.”.

Kush është dakord me nenin 16? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 është hartuar sipas propozimeve të bëra nga grupi i punës.

“Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, pas fjalëve “...transmetimi audioviziv...” shtohen “...së bashku me publikimin elektronik...”.

2. Në pikën 4 fjalët “...transmetimet audio dhe/ose audiovizive...” zëvendësohen me “...shërbimet e medias elektronike...”.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 është hartuar sipas propozimeve të bëra nga grupi i punës.

“Në pikën 1 të nenit 23, pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” dhe “dh” me këtë përmbajtje: “d) mbikëqyr zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e këtij ligji. dh) Mban dhe publikon Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve të Medies Elektronike.”.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19 është hartuar sipas propozimeve të bëra nga grupi i punës, i cili ndryshon nenin 30 “Ofruesit e shërbimeve medietike në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë” si më poshtë vijon:

“1. Ofruesi i shërbimit të medies, që është nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të respektojë rregullat që zbatohen për shërbimet e medies në Republikën e Shqipërisë.

2. Ofruesi i shërbimit të medies konsiderohet nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nëse: a) është themeluar në Republikën e Shqipërisë; b) nuk është themeluar në Republikën e Shqipërisë, por: i. përdor një stacion transmetimi satelitor tokësor që ndodhet në Republikën e Shqipërisë; dhe/ose ii. përdor kapacitetin satelitor që i përket Republikës së Shqipërisë; iii. përdor *domain*-et e administruara nga AKEP-i.

3. Ofruesi i shërbimit të medies konsiderohet, gjithashtu, nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nëse: a) zyra ose struktura e saj e menaxhimit është në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vendimmarrja editoriale realizohet brenda këtij territori; b) zyra ose struktura e saj e menaxhimit është në territorin e Republikës së Shqipërisë, por vendimmarrja editoriale për shërbimet e medies bëhet në një vend të BE-së, konsiderohet se ofruesi i shërbimit të medies është nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që pjesa më e madhe e personelit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve medietike të operojë në Shqipëri; c) një pjesë e konsiderueshme e stafit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve të medies vepron në Republikën e Shqipërisë dhe në një vend të BE-së, ofruesi i shërbimit të medies konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse selia e tij ndodhet në Republikën e Shqipërisë; ç) një pjesë e konsiderueshme e personelit në aktivitetet e shërbimeve medietike nuk operon as në Shqipëri, as në një shtet anëtar të BE-së, ofruesi i shërbimit të medies konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse aktiviteti i tij filloi për të parën herë në këtë vend, në përputhje me legjislacionin shqiptar, me kusht që ai të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme dhe efikase me

ekonominë shqiptare; d) interesat e saj fitimprurëse kryesore lidhen me subjektet tregtare të themeluara sipas ligjit shqiptar ose që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë; dh) mbi 50% e përdoruesve/ndjekësve/abonentëve janë rezidentë të Republikës së Shqipërisë; e) komunikimi/publikimi i tij i parë ndaj publikut të gjerë po bëhet në Shqipëri/për Shqipërinë.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për ato shërbime të medias që, edhe pse nuk përfshihen në pikat 2 e 3, të këtij neni: a) përdorin një lidhje satelitore nga territori i Republikës së Shqipërisë; b) nuk përdorin lidhje satelitore nga territori i Republikës së Shqipërisë, por përdorin hapësirën transmetuese satelitore dhe burimet që i përkasin Republikës së Shqipërisë.

5. Kur një ofrues i shërbimit të medias elektronike ka selinë në Republikën e Shqipërisë, por vendimet për shërbimet e kësaj media bëhen në një vend të tretë ose anasjelltas, ofruesi konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, me kusht që shumica e stafit/fuqisë punëtore të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve të medias të funksionojnë në Republikën e Shqipërisë.

6. Nëse juridiksioni nuk mund të përcaktohet sipas pikave 2 deri 6, të këtij neni, shteti anëtar kompetent është ai në të cilin ndodhet OSHMA-ja, në kuptim të neneve 49 dhe 50, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së e shteteve anëtare të saj.

7. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, çështja e juridiksionit, në përputhje me pikën 6 të këtij neni, do të zgjidhet në përputhje me nenet 49 deri 55 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian.”.

Kush është dakord me nenin 19?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër!

Vasilika Hysi – Po, meqenëse zonjën Kokona nuk e kishim në komision. Pati një diskutim nga një kolege për ndryshimin e foljes “bëhet” me “merret”. Pra, në shkronjën “b” të pikës 3, ku thuhet: “Vendimmarrja editoriale për shërbimet e medias merret në një vend të BE-së...” dhe te pika 5 ku thuhet: “Vendimet për shërbimet e kësaj medie...” në vend të fjalës “bëhen”, të shkruhet “merren”, a mund të bëhet ky ndryshim gjuhësor? Ne nuk guxuem, pasi ky është një nen shumë delikat, që përputhet edhe me direktivat e BE-së dhe do të donim opinionin tuaj.

Milva Ekonomi – Po.

Elira Kokona – Përsëri është një vërejtje me karakter të pasur gjuhësor, në logjikën e gjuhës shqipe thuhet “merren vendime”, sepse vendimet nuk bëhen.

Milva Ekonomi – Dakord.

Kush është dakord me propozimin?

Dakord.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Edhe ky nen është amenduar nga grupi i punës. “Në nenin 31 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit 31 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Llojet e ofruesve të shërbimeve medietike”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Në përputhje me mënyrën e komunikimit me publikun e gjerë, ofruesit e shërbimeve të medias së shkruar janë si më poshtë vijon:

a) Shtypi i shkruar;

b) Publikimet elektronike”.

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër.

Elira Kokona – Referenca që lidhej me nenin 2, nëse nuk gaboj, kishte të bënte pikërisht me këtë nen, prandaj kërkoj, nëse është e mundur, të përdoret e njëjta referencë, pra ky ligj nuk zbatohet për shtypin e shkruar. Nëse themi “Nuk zbatohet për medien e shkruar”, u referohemi gjithashtu publikimeve elektronike. Në fakt, qëllimi është të mos zbatohet për shtypin e shkruar. Prandaj, nëse është e mundur, të bëhet kjo referencë.

Milva Ekonomi – Si propozoni të jetë?

Elira Kokona – Të thuhet “shtypi i shkruar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të unifikohet termi siç është këtu edhe te neni 3, sepse ndryshe dalim përtej qëllimit.

Milva Ekonomi – Pra, rikthehem te neni 2 dhe heqim “medie e shkruar” dhe themi shtypi i shkruar” dhe nuk vëmë referenca te ligji...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elira Kokona – Ta unifikojmë në kuptimin e këtij ligji.

Milva Ekonomi – Të lutem, shënoje pak komentën për nenin 2, i cili unifikohet me nenin 21.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Musa Ulqini – Është te neni 3 ku thuhet: “Ky ligj nuk zbatohet për shtypin e shkruar”.

Milva Ekonomi – Dakord, shënoje pak komentën.

Neni 21. “Në shkronjën “ë”, të pikës 1, të nenit 33, pas fjalëve “... të drejtat e autorit ...” shtohen fjalët “... transmetimit, ritransmetimit ...”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. “Pas nenit 33 shtohen nenet 33/1 dhe 33/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 33/1 “Detyrimet e OSHPE”

1. Ofruesi i Shërbimit të Publikimit Elektronik duhet të bëjë lehtësisht të aksesueshëm, në mënyrë direkt dhe të përhershme për publikun e gjerë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin e ofruesit të shërbimit;

b) Vendndodhjen e zyrave qendrore ose vendqëndrimin e ofruesit të shërbimit, adresën e tij elektronike ose atë të faqes së internetit;

c) Organin kompetent të ofruesit të shërbimit.

Institucionet përgjegjëse njoftojnë AMA-n lidhur me procesin e regjistrimit të ofruesve të shërbimit të mediave elektronike. AMA pasqyron të dhënat në regjistrin e ofruesve të shërbimit të mediave elektronike.

2. Një ofrues i shërbimeve të publikimeve elektronike duhet të publikojë paralajmërim të përshtatshëm për përmbajtjen e publikimeve, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, shëndetësor, moral, mendor, intelektual, emocional dhe social të të miturve.

3. E drejta e korrigjimit dhe e përgjigjes ndaj informacionit të publikuar, nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve të publikimeve elektronike, do të ushtrohet në përputhje me ligjin që rregullon mediat.

4. Ofruesi i Shërbimit të Publikimeve Elektronike nuk duhet të nxisë, të shtojë nxitjen ose të përhapë urrejtje apo diskriminim në bazë të racës, prejardhjes etnike, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjendjes financiare, arsimit, statusit social,

gjendjes martesore ose familjare, moshës, gjendjes shëndetësore, paaftësisë, trashëgimisë gjenetike, identitetit gjinor apo orientimit seksual.

5. Publikimi i informacionit që zbulon identitetin e të miturit nën moshën 18 vjeç, i përfshirë në çdo rast të dhunës, pa marrë parasysh nëse është dëshmitar, viktimë, i dyshuar apo i dënuar, ose zbulimin e ndonjë veçantie të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të një fëmije, ndalohet.

Neni 33/2, “Regjistrimi i Ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike”.

Një person fizik a juridik, i cili ofron shërbime të publikimeve elektronike, do të aplikojë tek AMA për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të tij në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Medietike. Ky regjistrim nuk është parakusht për të ofruar shërbimin.”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kam një ndërhyrje që na ka shpëtuar te Komisioni i Ligjeve. Për korrektesë, kjo është e bazuar në një studim të fundit që ka bërë Këshilli Kombëtar i Medies, ku një nga shkeljet kryesore që zë vendin e parë në portalet *online* është cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë.

Pra, te pika 5, ku flitet për publikimin e informacionit që zbulon identitetin e të miturit nën moshën 18 vjeç, i përfshirë në çdo lloj dhune, pa marrë parasysh nëse është dëshmitar, viktimë e/i dyshuar gjatë procesit të hetimit apo shkelës. Kur themi “shkelës”, tregon që ka një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe është e provuar që është fajtor. Pjesa më e madhe e cenimit të privatësisë nga medie dhe prezumimit të pafajësisë është kur policia ndalon dhe arreston dikë dhe pa qenë fajtor thotë: kriminel, vrasës e të tjera. Këtë dua të shtoj dhe për të qenë konform me kodin...

Milva Ekonomi – Çfarë doni të shtoni, zonja Hysi?

Vasilika Hysi – Fjalën “i dyshuar”. Pra “nëse është dëshmitar, viktimë, i dyshuar ose shkelës i ligjit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra, fjala “shkelës” ...

Musa Ulqini – Ju lutem, formulojeni edhe një herë saktë.

Vasilika Hysi – “Publikimi i informacionit që zbulon identitetin e të miturit nën moshën 18 vjeç, i përfshirë në çdo rast të dhunës, pa marrë parasysh nëse është dëshmitar, viktimë, i dyshuar apo i dënuar për një vepër penale...”.

Milva Ekonomi – A jeni dakord me ndryshimin që bëri zonja Hysi? A ka ndonjë opinion nga përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave apo të Ministrisë së Drejtësisë? Nuk ka.

Kush është dakord me ndryshimet që pëson neni 22 me këto ndërhyrje?

Dakord.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23. Ky nen është ndryshuar që kur është bërë propozimi fillestar, sepse për këtë nen ka dhënë komente OSBE-ja dhe grupi i punës, prandaj lexohet me këtë përmbajtje: “Pas nenit 37, shtohet neni 37/1 me këtë përmbajtje:

Neni 37/1 “Regjistri i Ofruesve të Shërbimeve të Medias Elektronike”

1. AMA mban, administron dhe publikon një regjistër të ofruesve të shërbimit të medias, të licencuar, të autorizuar ose jo.

2. Përmbajtja e aplikimit të referuar në nenin 33\2 dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të përditësuar miratohen nga AMA. Regjistri sipas pikës 1 të këtij neni përmban në veçanti:

- a) emrin e shërbimeve të medias;
- b) emrin e ofruesit të shërbimit të medias dhe informacion për shërbimin e ofruar;
- c) numrin dhe datën e lëshimit të licencës, arsyet për ofrimin e shërbimeve, nëse ofrohet pa asnjë detyrim për të marrë autorizim ose licencë;
- ç) llojin e shërbimeve të medias në përputhje me këtë ligj;
- d) periudhën për të cilën lëshohet autorizimi apo licenca;
- dh) të dhëna për personin përgjegjës të ofruesit të shërbimit të medias elektronike;
- e) informacion rreth masave të vendosura ndaj ofruesit të shërbimit të medias elektronike.

3. Pas mbarimit të afatit të parashikuar në licencën apo autorizimin e lëshuar, AMA kryesisht ose me kërkesë nga subjekti i interesuar fshin nga regjistri ofruesin e shërbimeve të medias elektronike dhe njofton autoritetet përgjegjëse, të cilat kanë informuar AMA-n lidhur me këtë subjekt.

4. Ofruesit e shërbimeve të medias elektronike, që nuk janë regjistruar në këtë regjistër ose që nuk i kanë përditësuar të dhënat në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AMA, nuk përfitojnë lehtësira fiskale apo të ndonjë lloji tjetër”.

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Elira Kokona – Sekretaria duhet të bëjë kujdes, që të përdorim të njëjtën shprehje kudo. Pra, nëse duhet të përdorim shprehjen “Regjistri i Ofruesve të Shërbimeve të Medies Elektronike”, atëherë duhet të ndryshohet edhe te neni 33/2, ku ka mbetur “medietike”, por mbi të gjitha duhet të ndryshohet përkufizimi. Pra, të unifikohen.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Kokona! Keni shumë të drejtë dhe sekretaria do të ketë kujdes.

Neni 24. Ky nen kërkon këto ndryshime: “Pas pikës 6 të nenit 42, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

Neni 6/1. “Të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive dhe publikimet elektronike për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingot televizive, janë të ndaluara.”.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25. Ky nen ka komente nga grupi i punës dhe ka këtë përmbajtje: “Pas nenit 51 shtohet neni 51/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 51/1, “Procedurat për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave”.

1. OSHPE-ja ka detyrimin të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e publikuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33/1 të këtij ligji.

2. Ankesa i paraqitet OSHPE-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e publikimit/transmetimit të përmbajtjes, ose në rastin e dy ose më shumë publikimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e publikimit/transmetimit më të fundit.

3. Personi që pretendon shkeljen ka të drejtë t’i kërkojë ofruesit të shërbimit të publikimit elektronik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën, heqjen e përmbajtjes.

4. Ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik, brenda 72 orësh nga marrja e ankesës, shqyrton ankesën dhe informon ankuesin.

5. Nëse OSHPE-ja refuzon ankesën ose nuk kthen përgjigje brenda 72 orësh nga marrja e saj, personi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit të Ankesave. Këshilli i Ankesave, brenda 72 orësh nga depozitimi/paraqitja e ankesës, vendos mbi ankesën përkatëse ose nga paraqitja e pretendimeve të OSHPE-së në rastet e zbatimit të pikës 6 të këtij neni.

6. Këshilli i Ankesave, kur e çmon të nevojshme, ia kalon ankesën e paraqitur OSHPE-së për të paraqitur pretendimet e veta brenda 48 orësh.

7. Pas shqyrtimit të ankesës dhe/ose pretendimeve të OSHPE-së, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, merr masat përkatëse, duke përfshirë sanksionet në përputhje me këtë ligj. Në çdo rast, Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHPE-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat.

8. OSHPE-ja publikon konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 48 orësh nga marrja e njoftimit, në mënyrë të njëjtë me atë të publikimit, kundrejt të cilit është bërë ankesa.”.

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26. Ky nen ka këto ndryshime të bëra nga grupi i punës: “Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, numri “ ... 7 ... ” zëvendësohet me “ ... 3 ...”.

2. Në pikën 6, pas fjalëve “... periudhë sa më të shkurtër ...” shtohen fjalët “ ... por jo më vonë se 5 ditë ...”.

Kush është dakord me nenin 26? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27. Ky nen është i shtuar nga Komisioni i Ligjeve. Në nenin 53, pika 15 ndryshon si më poshtë vijon:

15. “Vendimi i AMA-s mund të kundërshtohet në Gjykatën Administrative, Tiranë”.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28. Ky nen vjen si propozim i ekspertëve të OSBE-së, por është punuar edhe nga grupi i punës dhe ka këtë përmbajtje: “Pas nenit 53, shtohet neni 53/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 53/1 “E drejta e përgjigjes për OSHPE-të”

1. Çdo person, reputacioni i të cilit është cenuar drejtpërdrejt nga publikimi i fakteve dhe informacioneve të pavërteta dhe/ose të pasakta prej OSHPE-së, ka të drejtën e përgjigjes.

2. Personi, që ka të drejtën e përgjigjes, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit të shërbimit të publikimit elektronik, duke parashtruar arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij.

3. Kërkesa për të drejtën e përgjigjes duhet të paraqitet tek OSHPE-ja brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i fakteve dhe informacioneve që pretendohen të pavërteta dhe/ose të pasakta.

4. Brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës, OSHPE-ja vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes dhe për këtë njofton me shkrim kërkuuesin.

5. Ofruesi i Shërbimeve të Publikimeve Elektronike, nëse vendos për ushtrimin e së drejtës, publikon përgjigjen e çdo personi që është cenuar/përmendur nga publikimi, pa kosto financiare për personin e cenuar/përmendur. Përgjigjja duhet të publikohet e plotë, e dukshme dhe në të njëjtën faqe ku është publikuar materiali që kontestohet. Nëse publikimi hiqet nga faqja/portali përpara se përgjigjja e personit të cenuar/përmendur të publikohet, përgjigjja duhet të jetë e vendosur në një pozicion të krahasueshëm dhe për të njëjtën kohëzgjatje si publikimi i mëparshëm.

6. Ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike nuk kanë detyrim të publikojnë përgjigjen siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, nëse:

- a) pala e cenuar/përmendur nuk ka interes të ligjshëm për të dhënë përgjigje;
- b) përgjigjja në mënyrë të papërshtatshme tejkalon shkallën e pohimit të fakteve që kontestohen;
- c) përgjigjja nuk kufizohet vetëm në informacion faktik ose përfshin përmbajtje që kanë të bëjnë me ndjekjen e një procedure penale.

Ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike nuk kanë detyrim të publikojnë përgjigjen për lajmin/informacionin e kontestuar në lidhje me raportimet direkte në sesionet e hapura të organeve të Kuvendit dhe organeve të tjera shtetërore.

7. Nëse kërkuesi nuk merr një përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, prezumohet se OSHPE-ja ka refuzuar kërkesën.

8. Këshilli i Ankesave brenda 72 orësh, nga paraqitja e një ankese për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga një OSHPE, shqyrton çështjen dhe, nëse e gjen të drejtë ankesën e bërë, i kërkon OSHPE-së korrigjimin e fakteve dhe informacioneve në lidhje me personin e interesuar, në një mënyrë të ngjashme dhe kohë të njëjtë me atë të publikimit, objekt ankese, brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit:

- a) Në fillim të procedurës së shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkon OSHPE-së, të cilës i adresohet ankesa, dhënien e shpjegimeve në lidhje me këtë ankesë.
- b) Këshilli i Ankesave i dërgon ankuesit dhe OSHPE-së përkatëse konkluzionet e arsyetuara për rastin.

9. Këshilli i Ankesave mund të refuzojë një ankesë kur:

- a) vlerëson se ajo është abuzive dhe e pabazuar apo e bërë në keqbesim;
- b) e drejta e kërkuar për përgjigje është opinion personal i personit dhe nuk ka të bëjë me rregullimin e ndonjë lajmi me karakter fakti apo informacioni;
- c) e drejta e kërkuar për përgjigje përmban parashtrimin e fakteve dhe informacioneve të rreme;
- ç) e drejta e kërkuar për përgjigje është bërë për të kërkuar parandalimin e veprimeve të pritshme apo që nuk kanë ndodhur ende;
- d) përmbushja e së drejtës për përgjigje përfshin një ndëshkim, kapërcen rregullat e mirësjelljes apo sjell dënimin e ofruesit të shërbimit medietik në një proces gjyqësor civil;
- dh) personi i dëmtuar nga informacioni i kundërshtuar nuk ka interes të ligjshëm në momentin e kërkesës për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes;
- e) përmbajtja e publikimit të kundërshtuar përmban thënie apo deklarime të personit të cenuar, që konsiderohen të barasvlershme me vetë përgjigjen e kërkuar ose kur personi ka dhënë pëlqimin paraprak në një mënyrë formale lidhur me përmbajtjen e publikimit;
- ë) një korrigjim i barasvlershëm i të dhënave të informacionit të kundërshtuar është bërë paraprakisht dhe për këtë është njoftuar personi i cenuar;
- f) përmbajtja e përgjigjes së kërkuar dhunon të drejtat e një pale të tretë;
- g) çështja objekt ankese lidhet me thëniet gjatë veprimtarive parlamentare, zhvillimit të seancave gjyqësore apo transmetimit të veprimtarive të subjekteve politike;
- gj) publikimi i së drejtës për përgjigje nuk është në interes të publikut;
- h) kërkesa është paraqitur në tejkalim të afatit.

10. Kundër vendimit të AMA-s bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë”.

Kush është dakord me përmbajtjen e këtij neni? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kolegë, dua t’ju njoftoj se ministrja ka një angazhim në orën 19:00. A mund t’i japim leje të largohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit, zonja Gjonaj!

Neni 29. Ky nen është bërë edhe sipas propozimit të ekspertëve të BE-së, të cilin po e lexoj, për të rënë dakord.

“Neni 132 ndryshohet, si më poshtë vijon:

Neni 132, “Masat për shkeljet”.

ii. Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, në përputhje me procedurat dhe parashikimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij, pas marrjes së mendimeve të organeve përgjegjëse, nëse parashikohen, AMA (Bordi dhe/ose Këshilli i Ankesave) vendos:

a) detyrimin e ofruesit të shërbimit të medias:

i. për të publikuar formulën e korigjimit sipas formës dhe përmbajtjes së parashikuar në nenin 53/1 të këtij ligji;

2. për të kërkuar nëpërmjet AKEP-it vendosjen e një njoftimi të karakterizuar teknikisht si “*pop up*”;

b) për të vendosur gjobë, shuma e së cilës përcaktohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij;

c) për të vendosur pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;

ç) për të vendosur uljen e kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës dhe/ose autorizimit;

d) për të vendosur heqjen e licencës dhe/ose autorizimit”.

(Ndërhyje pa mikrofon.)

Më lini ta mbaroj deri në fund dhe pastaj do t’i rikthehem.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka gjë.

“2. AMA në vendimin e saj merr në konsideratë masën dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer sipas rregullave të përcaktuara në shkronjën “k” të paragrafit 1, të nenit 19 të këtij ligji.”

Kolegë, a mund të mbajmë pak qetësi?

“3. AMA vendos sanksione të parashikuara në këtë ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.

4. Kur AMA vëren shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat me ligj vendosin sanksione organet e tjera shtetërore, atëherë ajo njofton këto të fundit.

5. Për shkelje të kryera nga OSHPE-të, për përmbajtjen e publikimeve elektronike, në bazë të një vendimi të marrë nga AMA, në vijim të procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe pas marrjes së mendimit me shkrim nga AKCESK-u, Autoriteti i Komunikimit Elektronike dhe Postar (AKEP):

a) Të urdhërojnë heqjen menjëherë të përmbajtjes së caktuar, menjëherë por jo më vonë se 60 minuta nga njoftimi, në rastet kur shërbimet e medias elektronike dyshohet së mund të nxisin kryerjen e një prej veprave penale në vijim: pornografi me fëmijë, inkurajim të akteve terroriste dhe shkelje të sigurisë kombëtare. Në rast të moszbatimit të urdhrit brenda afatit të përcaktuar, të bllokojë aksesin në internet.

b) Të vendosë njoftim *pop up* në faqen e internetit *domain*-in e portalit, i cili përmban informacion për vendimet e organeve vendimmarrëse të AMA-s. Në marrjen e vendimit sipas shkronjës “a” të kësaj pike, AMA, pasi dëgjon ofruesin e shërbimit të publikimeve elektronike dhe, nëse është e mundur, autorin e përmbajtjes së publikuar, vlerëson shkeljen e kryer në raport me cenimin e të drejtës së lirisë së shprehjes, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

6) Kundër vendimit të bllokimit të aksesit në internet, subjekti ka të drejtë të bëjë ankim pranë AMA-s, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së njoftimit ose pikës 3 të këtij neni. AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin jo më vonë se 7 ditë pune. Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative.

7) Vendimet e AMA-s ekzekutohen nga Shërbimi Përmbarimor sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë taksën apo tarifën për Shërbim Përmbarimor.

8) Kundër vendimit të Këshillit të Ankesave të AMA-s mund të bëhet ankim sipas dispozitave të pikës 6 të këtij neni. Ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave.

9) Vendimet e Këshillit të AMA-s do të ekzekutohen nga shërbimi i përmbarimit gjyqësor në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë tarifën, ose tarifën për Shërbimin Përmbarimor.

Ky është neni.

Zonja Kumbaro, keni fjalën.

Mirela Kumbaro – Unë kam një shqetësim te pika 1 e këtij neni, shkronja “a”, pastaj do të shkoj të shkronjat “i” dhe “ii”. Ka një problem me ndërtimin e të gjithë strukturës, sepse nuk kuptohet kush bën çfarë. Mund të jetë shprehur nga ekspertët në anglisht dhe kemi një përkthim jo të saktë në shqip.

Ju kërkohet, të nderuar kolegë, të më dëgjoni me vëmendje leximin e pikës 1:

“Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, në përputhje me procedurat, nëse parashikohen dhe pas marrjes së mendimeve të organeve përgjegjëse, AMA vendos detyrimin e ofruesit të shërbimit të medias, për të publikuar formulën e korrigjimit sipas formës dhe përmbajtjes”. Pastaj detyrimin për ofruesin e shërbimit të medias për të kërkuar nëpërmjet AKEP-it vendosjen e një njoftimi të karakterizuar teknikisht si *pop up*, që e lexuar kështu do të thotë që vetë ofruesi i medias i kërkon AKEP-it, vendosjen e njoftimit, ndërkohë unë e kuptoj që ofruesi i shërbimit të medias e pëson, pra ka detyrimin të zbatojë urdhrin e AKEP-it, të cilit AMA ia kërkon me atë vendim për vendosjen e *pop up*-it. Pra, kemi një problem në mënyrën si është shprehur. I njëjti gabim vazhdon: “vendos për të vendosur gjobë, shuma e së cilës përcaktohet në përputhje me...”.

Vasilika Hysi – Shqetësimi që ngre zonja Kumbaro është shumë i drejtë. Ne kemi bërë një riformulim. Në fakt, ishte zoti Hyseni, i cili e ngriti shqetësimin që ata i kanë sjellë në anglisht dhe u la që gjatë redaktimit të draftit, sepse kemi departamentin e redaktimit gjuhësor, të rregullohet.

Nga ana tjetër, pati një shqetësim përfaqësuesja e AKEP-it në Komisionin e Ligjeve, ku tha se vendimin për të vendosur një njoftim *pop up* e ka AMA, ndërsa AKEP-i ka detyrimin për ta zbatuar. Pikërisht ajo që thotë zonja Kumbaro, që ka nevojë të riformulohet dhe të shkruhet shqip është e drejtë.

Milva Ekonomi – Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Unë kam një pyetje për nënkryetaren e Kuvendit, si juriste shumë e njohur e Republikës. Për pikën 8 ka diskutime të tejskajshme dhe gjëra edhe të qarta, edhe të paqarta, por për këtë pikë ka një reagim të jashtëzakonshëm. A është korrekt kjo me ligjin, me Kushtetutën, me mënyrën si formulohet? Kundër vendimit të KA-së së AMA-s mund të bëhet ankim sipas dispozitave të pikës 6 të këtij neni: “Ankimimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave”.

A është në rregull kjo, se këtu rreh i gjithë problemi?! Pra, KA-ja të vendos ty një gjobë 10 milionë, fiton në gjyq, por pastaj je i detyruar të paguash. Unë nuk jam jurist, thjesht përcjell një shqetësim shumë të madh të të gjithëve dhe ne nuk mund të rrimë këtu pa dhënë asnjë koment për t’i dhënë një përgjigje dhe ta përballojmë problemin juridikisht, në mënyrë të saktë dhe të jemi korrektë. Nuk ka rëndësi si reagojnë të tjerët, kur ne jemi të drejtë me ligjin, me Kushtetutën dhe me të gjitha standardet.

Vasilika Hysi – Në fakt, zoti Ulqini, kjo çështje është diskutuar sot në Komisionin e Ligjeve mes kolegëve jurist, nëse ankimi mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit të KA-së. Bashkërelatorja, zonja Bushka, e cila mbron variantin e ardhur, sugjeroi që të lihet në këtë formë, me argumentin se vendimet e KA-së nuk janë vetëm për portalet, por janë edhe për televizionet dhe mediat. Ndërkohë, zoti Hysni ndante një mendim tjetër, ai mendonte se duhet bërë një dallim në faktin nëse duhet të pezullohet ekzekutimi i një vendimi apo jo.

Shumë të rëndësishme në zbatimin e këtij ligji janë aktet nënligjore, që do të nxjerrë AMA dhe respektimi i parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së gjobës. Gjykata e Strasburgut kërkon tri elemente shumë të rëndësishme në vlerësimin e masave, si, për shembull, gjoba dhe proporcionaliteti.

Unë besoj se do të ketë një asistencë nga ekspertët ndërkombëtarë në draftimin e akteve nënligjore për AMA-n, me qëllim që zbatimi i gjobave, kam parasysh portalin, peshën, përfitimin ekonomik, mundësitë financiare që ka, rëndësinë e shkeljes, faktin nëse shkelja është bërë më shumë se një herë, pasojat që kanë ardhur nga shkelja, ka një sërë faktorësh që analizohen.

Në këtë kuadër besoj se duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse gjobat duhet të jenë proporcionale, pra duhet të jenë shumë mirë të menduara, për të mos rënduar mbi portalet online, që kanë një numër të kufizuar personash, nuk kanë fitime, nuk janë njëloj si një televizion i madh që ka të ardhura etj. Ne nuk arritëm të ndaheshim në Komision të Ligjeve, sepse i bie që të përfitojë ajo pjesë që shpesh opozita i quan oligarkë.

Musa Ulqini – Gjithçka që lidhet me proporcionalitetin do ta diskutojmë kur të arrijmë në neni 30. Unë u shpreha gabim, sepse nuk ka rëndësi nëse gjoba është 1 lek apo 1 milion euro. Kjo fjalë “ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave” a është në përputhje me mënyrën si funksionon ligji? A është standard i BE-së? A na vë kjo në pozitë të vështirë? Nuk e kam me këta që e kundërshtojnë dhe janë në konflikt interesi, por me standardet, me Gjykatën e Strasburgut dhe me standardet e BE-së. Nëse kjo është në rregull...

Elira Kokona – Në fakt, sugjerimi i zonjës Kumbaro është korrekt, por po të shohim propozimin e ardhur nga qeveria, neni 132 ka qenë i ndarë në 2 dispozita: 132 dhe 132/1. Në versionin e ardhur nga qeveria thuhet: “Në rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, sipas neneve 33/1, 51/1 dhe 53/1 të këtij ligji, Këshilli i Ankesave vendos: a) detyrimin e ofruesit të shërbimit të medias, për të publikuar formulën, hequr përmbajtjen dhe vendosjen nëpërmjet AKEP-it edhe gjobë”.

Milva Ekonomi – Këtë do ta shohim.

Elira Kokona – Doja të thosha që është korrekte dhe mjafton të merret një koordinim i mirë i të dyja neneve, sepse sugjerimi i ekspertëve për të bërë një unifikim, për të mos ndryshuar arkitekturën e ligjit aktual, tregoi që duhet të mbanim ligjin aktual, ndonëse neni 132 bëhet shumë i gjerë dhe i vështirë për t’u zbatuar. Ne, për teknikë legislative, e kishim ndarë në dy dispozita, në 132/1 dhe 132, duke ndarë mënyrën se si ai zbatohet në kuadër të dispozitave, që përcaktonte shkeljet. Ekspertët e specializuar në fushën e komunikimit sugjeruan që ne të vazhdonim të mbanim arkitekturën e nenit të ligjit aktual, duke e mbajtur 132-in si një nen të vetëm, disi të gjatë, disi të vështirë për t’u lexuar, por korrekt. Bashkimi i tyre në momentin e fundit, ka sjellë mbase keqkuptime në hartim.

Do t’u kërkoja kolegëve të sekretarisë që të shohin të dyja dispozitat, për të bërë të mundur reflektimin sa më të qartë.

Për sa i përket shqetësimit të deputetit Ulqini, dua të theksoj faktin se Kodi i Procedurës Administrative i referohet qartësisht ekzekutimit të akteve administrative, siç janë vendimet e AMA-s, në nenin 164, ku parashikon shumë qartë mundësinë e tipologjisë së caktuar të akteve për të qenë të ekzekutueshëm, pavarësisht procedurës së ankimimit. Në pikën 2 thuhet: “Akti administrativ fillon të ekzekutohet pas përfundimit të afatit, pas njoftimit të afatit për njoftimin e vendimit për heqjen e efektit pezullues. Pas njoftimit të vendimit vendos organi kompetent”. Pra vendimi i organit kompetent, i cili ndryshon vendimin, bëhet i ankimueshëm.

Gjithashtu, vazhdon me dispozitë tjetër, që i referohet parimit të ekzekutimit të detyrueshëm. Kodi i Procedurës Administrative parashikon shumë qartë që ka një mundësi që vendimet e organeve administrative të mund të ekzekutohen pavarësisht ankimimit. Në jetën tonë të përditshme edhe në vendime të tjera të rëndësishme, jo vetëm në fushën e medias, por edhe në fusha të tjera, gjejmë këtë mundësi të ekzekutimit të vendimeve, pavarësisht ankimimit.

Në fakt, kjo ka ardhur nga legjislacione të tjera, nuk është një reflektim i legjislacionit shqiptar, dhe ka ardhur shpesh nga pamundësia e sistemit gjyqësor për të përfunduar në kohë të arsyeshme procedurat ankimese, duke u dhënë mundësinë individëve ose organizmave të caktuar të ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre, pavarësisht ankimimit. Në momentin që përfundon vendimarrja në gjykatë, palët i rikthehen situatës së mëparshme, duke vendosur në vend gjendjen e tyre. Pra, sistemi gjyqësor dhe i gjithë sistemi i arkitekturës sonë ligjore e ndihmon dhe e lejon këtë parashikim që kemi bërë këtu dhe insistoj të them që nuk është i izoluar, nuk është i vetëm.

Madje në shumicën e legjislacioneve të hartuara vitet e fundit, do ta gjeni shpesh në propozimet ligjore.

Desha të theksoj atë që tha deputetja Hysi. Është e vërtetë që proporcionaliteti nuk është një term që përdoret apo që përmendet në këtë dispozitë, por ai përshkon dhe ndjek, parimi i tij zbatohet, sidomos tipologjinë e mënyrën se si do të zbatohen gjobat.

Milva Ekonomi – Unë do të bëj vetëm një sugjerim.

Zonja Kokona, meqenëse ky është një nga nenet më të rëndësishëm të këtij ligji, do t'ju lutesha që formulimin për përmirësimet gjuhësore ta bëni bashkë me sekretarinë e komisionit.

E kanë kërkuar fjalën përfaqësuesit e AKEP-it dhe të AMA-s.

Kostaq Papa – Vetëm 1 sekondë, sa t'i përgjigjem zonjës për një defekt teknik në procedurën administrative. Vendimi gjyqësor dhe çdo lloj vendimi në lidhje me procedurën administrative, ashtu dhe në procedurën civile, në momentin e një ankimimi konsiderohet i pezulluar dhe nuk ushtrohet. Kam profesoreshën time këtu dhe nga praktika gjyqësore që kemi ndjekur, kur kemi një ankimim të një vendimi gjyqësor, detyrimisht nuk kemi kryerje të një vendimi, nuk kemi vazhdim të procedurës, por vazhdim të ankimimit.

Elira Kokona – Kjo që ju përmendët, është korrekte dhe e vërtetë, por ka një përjashtim në të gjitha ato raste ku në ligje specifike parashikohet ndryshe. Në këtë ligj po parashikohet ndryshe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po përmend diskutimin parimor.

Për sa i përket ligjit specific, e ka këtë parashikim edhe pa këtë ndërhyrje, sepse e parashikon shumë qartë edhe këtë mundësi. Për t'i dhënë përgjigje pyetjes nëse po cenojmë ndonjë standard, përgjigja është jo. Është një mundësi e parashikuar nga Kodi dhe nga legjislacioni kuadër dhe ne jemi duke e zbatuar. Ka legjislacione që po të kisha kohë, do t'jua citoja, ku përmendet ekzekutimi i vendimeve, pavarësisht ankimimit.

Kostaq Papa – Atëherë, të specifikohet, meqë ju jeni te rasti veçantë!

Milva Ekonomi – A ka pyetje të tjera?

Po, përfaqësuesi i AKEP-it.

Jetmir Braha – Faleminderit!

Ne kemi dy shqetësime te ky nen.

E para është te riformulimi që u kërkua i pikës 1/a/2, e cila në fakt është e njëjtë me formulimin në pikën 5/b të po këtij neni. Pra, jemi në momentin kur AMA po merr një vendim ndaj një portali dhe kështu siç është shkruar, kuptohet që portali i kërkon AKEP-it të publikojë një *pop up*, pra një mesazh shfaqës. Ne, si AKEP, e kemi parë që vendosjen e një detyrimi të tillë tek ofruesit e shërbimit internet, gjë e cila mungon këtu, sepse nuk është sqaruar që ky urdhër duhet të nxirret për ofruesit e shërbimit internet, duhet ta specifikojmë. Ky imponim do të jetë për ofruesit e shërbimit internet, me qëllim që ta ndajmë nga ofruesit e shërbimit të publikimit elektronik.

Milva Ekonomi – A e keni sjellë propozimin te Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese?

Jetmir Braha – Po dhe na u miratua heqja vetëm e termit “nëpërmjet AKEP-it”.

Milva Ekonomi – Ai është komisioni përgjegjës. A e keni bërë atje propozimin?

Jetmir Braha – Po, e kemi bërë dhe është e njëjtë me pikën 5/b, por edhe te kjo pikë ne kemi një merak. Po t’i rrimë formulimit të fjalisë “Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, te pika 5/b thuhet: “Të vendoset një njoftim *pop up* në faqen e internetit apo *domain*-it, i cili përmban informacion për vendimet e organeve vendimmarrëse të AMA-s”. Ne nuk mund ta vendosim këtë, sepse ne nuk kontrollojmë internetin në Republikën e Shqipërisë, ne nuk kemi një server ku kalon i gjithë interneti i Republikës së Shqipërisë, pasi janë ISP-të që ofrojnë akses në internet në Republikën e Shqipërisë. Prandaj, duhet të na ndryshohet pak emërtimi “të urdhërojnë vendosjen e një njoftimi *pop up*” dhe jo ta vendosim ne, se duket sikur do ta vendosë AKEP-i këtë njoftim në çdo faqe portali që do të gjykohet nga AMA dhe mundësisht të hiqet fjala “vendos”, sepse në kuptimin e AKEP-it ajo është një organ kolegjal dhe drejtohet me një këshill drejtues. Nëse do të duhet edhe një vendimmarrje e Këshillit Drejtues, atëherë koha shtyhet shumë për të ndërhyrë mbi një portal, ose për të urdhëruar ISP-të që të mbyllin një portal.

Milva Ekonomi – Këto përmirësime që propozoni i kaluat edhe në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese?

Jetmir Braha – Në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese u miratua vetëm heqja e shënimit “nëpërmjet AKEP-it”, meqenëse është pika 5/b më poshtë.

Elira Kokona – Shkronjat “a” dhe “b” janë dy gjëra të ndryshme dhe duhet të citohen patjetër, se janë dy kontekste të ndryshme.

Milva Ekonomi – A t’i lëmë kohë 5 minuta sekretarisë dhe zonjës Kokona pasi të kalojmë nenin tjetër, që ata ta riformulojnë dhe ta miratojmë?

Elira Kokona – Patjetër, por ne insistojmë që të paktën në grupin e punës përfaqësuesi i AKEP-it, se e kemi koordinuar qartë me të, mos shihni këtë version se nuk është korrekt, korrekt është ai i ardhur nga qeveria, ta riformulojmë që të mund të përkojë.

Milva Ekonomi – Ne kemi versionin që ka ardhur nga përpunimi i të gjitha dokumenteve, zonja Kokona, kështu që versioni i qeverisë është i kaluar, tani duhet të përmirësojmë këtë version që kemi.

Elira Kokona – Jam shumë dakord, iu referova kolegut për të lexuar versionin korrekt teknikisht, por teknikisht, edhe në bashkëpunim me kolegët e OSBE-së, AMA nuk mund të vendosë dhe të ketë kontakte me ISP-të, pasi raportin me ISP-të e ka vetëm AKEP-i, i cili ushtron funksionet e tij në kuadër të kompetencave të tij. Parimisht ne nuk mund ta dimë nëse AKEP-i bashkëpunon dhe si i ka raportet me ISP-të. Kjo është pjesë e kompetencës së AKEP-it dhe kjo ka qenë arsyeja pse nuk e cituam raportimin se si AKEP-i e zbaton këtë detyrim ligjor.

Megjithatë unë jam e hapur për çdo diskutim dhe riformulim teknik në këtë aspekt.

Milva Ekonomi – Po, patjetër!

Gentian Sala - ...që i referohet ligjit aktual për çështjen e ankimit. Edhe njëherë, të pika 8 thuhet: “Kundër vendimit të KA-së së AMA-s mund të bëhet ankim sipas dispozitës së pikës 6, që thotë: “bëhet ankim pranë AMA-s””. Pra, Këshilli i Ankesave vendos gjobën, subjekti ankohet te AMA. Pastaj vazhdon: “Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave”. Pra, kështu siç e kuptoj unë, KA-ja vendos gjobën, subjekti ankohet te bordi i AMA-s, por ndërkohë KA-ja mund të vazhdojë ekzekutimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po AMA vendos, të bjerë gjoba pastaj!

Një institucion bën dy procedura. Çfarë problemi ka që të pritet? Gjobën aktualisht e vendos kryetari. Në rastin konkret, subjekti ankohet te bordi, vendos bordi dhe shkon për titull ekzekutiv. Kështu si e kuptoj unë krijohen dy borde.

Milva Ekonomi - Dy struktura.

Gentian Sala - Dy struktura paralele.

Milva Ekonomi - Sugjerohet të mbetet siç ka qenë.

Fidel Ylli - Si do të shkohet pastaj në gjykatë?

Milva Ekonomi – Siç shkohet aktualisht.

Fidel Ylli - Si? Pasi të më falimentosh mua? Nuk ka logjikë!

Elira Kokona - Arsyeja pse u vendos një propozim i tillë, tipike e legjislacioneve të caktuara, është se koha e humbur, koha që përshkohet për të shkuar drejt gjetjes së zgjidhjes gjyqësore, është e tillë që vazhdon dhe shkakton dëmin. Pra, jemi të gjithë të bindur për faktin se për dënimin që do të merrte edhe në mënyrë indirekte, ofruesi i shërbimit mediatik në momentin që prodhohet dëmi, do të kishim nesër një gjykim në gjykatë, për sa i përket procesit të shpifjes. Kjo do të kursente kohë, dëmin që i shkaktohet individit, por edhe gjobën që mund të marrë nesër, detyrimin pasuror apo moral që mund të marrë ofruesi i shërbimit nga ai vendimi i gjykatës. Në këtë kontekst kjo masë është me karakter parandalues.

Nga ana tjetër, duhet të shikojmë një gjë, tipologjia e masave dhe e shkeljeve u referohet grupimeve të të drejtave dhe detyrimeve. Kategoria e parë ka të bëjë me detyrimet kryesore, detyrimet madhore. Kategoria e dytë e gjobave u referohet aspekteve procedurale. Kategoria e tretë vazhdon me rastin klasik të problemeve që kanë ofruesit e shërbimit OSHMA, të cilët janë edhe sot subjekte të këtij ligji. Po t'i shikojmë të 3 kategoritë e shkeljeve, kanë kategori që u referohen ose problemeve madhore, ose aspekteve procedurale, të cilat parandalojnë shkaktimin e dëmit. Në të dyja këto raste, koha është e rëndësishme. Kjo ka qenë arsyeja, një diskutim që kemi bërë edhe me ekspertët ndërkombëtarë. Ata nuk shikojnë ndonjë problem në këtë kontekst. Ju mund të shikoni në 6 opinionet që kanë ardhur, janë mjaftueshëm të detajuara. Asnjëherë nuk ka ardhur ndonjë shqetësim për sa i përket kësaj tipologjie. Ne jemi duke folur për një gjobë, e cila do të jepet në mënyrë proporcionale. Po të shikoni tipologjinë e detyrimit, detyrimi që shkelet, për shembull, për të miturit, meqenëse u përmend rasti i të miturve, do të presim të shkohet në gjykatë, të bëjë xhiron e ankimeve, për të bërë të mundur që të miturit t'i ndërpritet tipologjia e cenimit. Jemi duke folur në një kohë ku konteksti i teknologjisë të shkakton dënim. Jemi të mendimit se duhet të qëndrojmë, por megjithatë e lëmë si ta çmoni ju.

Milva Ekonomi – Po, zoti Ylli.

Fidel Ylli - Unë i përmbahem asaj që thashë dhe e shikoj të pavend që në momentin që merret një vendim nga AMA, unë kam për detyrë të shkoj në gjykatë. Nuk mund ta marr gjobën, pse i kemi gjykatat në këtë nivel. Ne mundohemi që gjykatat me drejtësinë e re që po vjen do të operojnë shumë shpejt edhe për këto vendime. Nuk duhet të marrim një rast konkret, të flasim për fëmijët apo për diçka tjetër, se ka një dëm shumë të madh. Unë po flas në koncept të ligjit. Për mendimin tim është e gabuar që unë pa marrë vendimin e gjykatës, duhet të paguaj gjobën. Unë

falimentoj. Mund të marr të drejtën në gjykatë, atëherë çfarë kuptimi ka më mbrapa? Nuk e di se si shprehen kolegët, por mendoj se duhet të shikohet me shumë vëmendje.

Milva Ekonomi - Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Kolegu i adresohet rastit të gjobës, por masat për shkeljet që mund të japë Këshilli i Ankesave janë: e para, të publikojë formulën e korigjimit sipas formës dhe përmbajtjes.

E dyta, nëpërmjet AKEP-it të urdhërojë teknikisht të vendosë një *pop up*.

E treta, është gjoba. Besoj se zoti Ulqini dhe zoti Ylli kanë shqetësimin lidhur me gjobën, por një masë tjetër është pezullimi i përkohshëm i licencës ose i autorizimit, në rastet kur ka portale që bëjnë thirrje për terrorizëm, diskriminim apo cenohet siguria kombëtare. Masa tjetër është ulja e kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës ose autorizimit. Në fund, është heqja e licencës, autorizimit, që janë raste shumë të rralla dhe të përcaktuara shprehimisht në ligj.

Dallimi që do të bëjmë është ai për rastin kur merret si masë gjoba, por vendimet e tjera kanë të bëjnë me gjëra të tjera, siç është vendosja e të tjera. Kjo është çështja që diskutuam në Komisionin e Ligjeve dhe shqetësimi ishte vetëm për rastin e gjobës. Në rastin kur është cenuar fëmija, ka një video erotike, kemi thënë që ta heqim menjëherë dhe jo më vonë se 60 minuta. Nuk do të presim ta çojnë në ankim, në Gjykatën Administrative të fillojë procesi dhe të shkojë në Gjykatën e Apelit.

Ndërsa për gjobën, ka diskutime, kur gjoba vendoset për mediet audiovizive dhe kur ajo vendoset për portalet të cilat kanë fuqi ekonomike të ndryshme. Në komision, po e ritheksoj edhe një here, nuk donin të bënin këtë lloj diferencimi, sepse mund të ndodhë që të mos përfitojnë ato që janë portale, por të shmangen nga pagesat e gjobave mediet e mëdha të fuqishme, që kanë pronarë, biznese e të tjera. Ju jeni komisioni përgjegjës, ju e diskutoni, ne e patëm këtë diskutim. Edhe zoti Hyseni e ngriti, duke pasur parasysh një vendim të Gjykatës Kushtetuese lidhur me titujt ekzekutivë, që nuk pezullojnë ekzekutimin e tyre, ndërkohë që ka një ankimim në gjykatë. Nëse do t'i ndajmë në dy transhe: kur ka këto masa ankimi, nuk pezullojnë ekzekutimin e vendimit dhe në rastet e gjobave, është çështje tjetër dhe unë këtu nuk mund të shprehem.

Milva Ekonomi – Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini - Ndoshta është faji im, nuk jam jurist, por si deputet kam mundësi të kuptoj 2-3 gjëra që nuk shkojnë. Nuk e kam fare shqetësimin për asnjë lloj gjobe apo mase. Po flas shumë thjesht. Bordi i AMA-s zgjidhet nga Kuvendi dhe përbëhet nga 7 veta. Ky bord prodhon, zgjedh

sipas disa propozimeve Këshillin e Ankesave, që përbëhet nga 5 vetë me një procedurë të hapur, me konkurrim.

Tani, Këshilli i Ankesave merr një vendim, nuk ka rëndësi, nuk më intereson fare lloji i gjobës, po diskutoj vetëm për vendimin. Ky vendim ankimohet te bordi i AMA-s, që është një institucion i epërm, nga i cili ka buruar Këshilli i Ankesave, e ka prodhuar Kuvendi, janë kandidatë të përzgjedhur e të tjera. Këshilli i Ankesave i përbërë prej 5 vetash, që është zgjedhur nga AMA, vihet në një pozicion të tillë: vendimi i Këshillit të Ankesave duhet të zbatohet edhe kur AMA vendos kundër. AMA nuk ka fuqi, AMA që është një institucion kushtetues, që zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë. Kjo është një gjë që nuk shkon ligjërisht. Nuk mundet që ky institucion që e ka prodhuar Kuvendi i Shqipërisë, mbi bazën e 500 kërkesave, kritereve e të tjera, që është një fuqi e madhe juridike, të mos ketë fuqi dhe institucioni që e ka zgjedhur vetë, të jetë i njëjtë me të: kur AMA prej 5 vetash e merr vendimin, ai ekzekutohet dhe AMA është e detyruar që të barazohet me Këshillin e Ankesave. Kjo nuk ka logjikë. Ne jemi brenda institucionit, pse duhet të krijojmë këtë problem?! Nuk po them keqpërdorimin ekstrem të medias së qëllimshme, të painformuar të politikës sot. Këtu është *horror*. Ua krijojmë vetë mundësinë atyre që na sulmojnë. Po flas ligjërisht, nga pikëpamja e logjikës. Kam nënkryetaren këtu dhe i drejtohem asaj. Këtu diskutimet regjistrohen. Unë dua të kem një aleat që e njeh shumë mirë ligjin. A është e mundur, është korrekte, është ligjore që Këshilli i Ankesave dhe bordi të jenë me fuqi të njëjtë? Kur ne kemi institucionin, pse duhet të krijojmë këtë gjë? Ne duhet ta zgjidhim këtë gjë. Ky është *nonsens*. Nuk ka rëndësi se është për një lek, është për të hequr licencën apo me 10 milionë lekë, unë nuk futem në ato çështje, sepse është neni 30, neni më poshtë ku do të flas.

Milva Ekonomi - Çfarë mendoni?

A mund të bëjmë vetëm 5 minuta pushim?

(Pas pushimit)

Milva Ekonomi - Faleminderit shumë!

Na duhej kjo ndërprerje e shkurtër, pasi arritëm që të konsultonim disa gjëra. Në nenin 29 bëmë disa ndryshime, që lidhen jo vetëm me gjuhën teknike të adaptuar jo mirë, por edhe me disa ndryshime referencash. Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, a mund ta rilexoni nenin 29?

Besmir Beja - Faleminderit!

Siç diskutuam, ndryshimi lidhet kryesisht me pikën 6, ku është parashikuar e drejta e ankimimit ndaj vendimeve të AMA-s, në rastin kur trajtohen vendime që lidhen me bllokimin e aksesit në internet. Vendimi merret drejtpërdrejt nga bordi i AMA-s dhe rrjedhimisht nuk parashikohet e drejta e ankimimit përsëri në bordin e AMA-s, por është ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë në këto lloj rastesh.

Në rastet e tjera, të cilat lidhen me vendime procedurale që merren nga Këshilli i Ankesave, vendimi më pas mund të ankimohet në bordin e AMA-s. Ky i fundit është i detyruar që brenda një afati të caktuar, ta shqyrtojë këtë lloj vendimi. Ky është në thelb ndryshimi që u vendos këtu.

Milva Ekonomi – Ju lutem, lexojeni nenin!

Gentian Sala – “Kundër vendimeve të parashikuara në nenin 1, shkronja “a” e këtij neni, subjekti ka të drejtë të bëjë ankimin pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së njoftimit”. Fjalët: “Sipas pikës 3 të këtij neni” hiqen. Pra, është thjesht riformulim i pikës 6 që u referohet vendimeve procedurale. Shënimet janë mbajtur me shkrim dore dhe mund të ketë edhe gabime, por kur të zbardhet formulimi, do të jetë më i saktë.

“AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin jo më vonë se 10 ditë”. Ju mund të shpreheni, po ashtu edhe AMA, nëse afati i vlerësuar në këtë lloj rasti, është i mjaftueshëm për bordin e AMA-s për të shqyrtuar dhe për të marrë një vendim për çështjen. Kundër vendimit të AMA-s në këtë rast, mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative në Tiranë, pra në gjykatën e shkallës së parë. Ky është në thelb ndryshimi i propozuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo vijon të mbetet, është e njëjta lloj përmbajtjeje. Ajo që është me rëndësi për t’u theksuar në këtë lloj rasti është që ankimi, ashtu siç u shpjegua në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, si rast përjashtimor nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave.

Pra, thelbi është që bllokimin e vendos bordi i AMA-s, pastaj shkon në gjykatë, kurse për çështjet e gjobave e vendos Këshilli i Ankesave dhe duhet të ankohet në bord. Unë përsëri këmbëngul që kjo nuk duhet ta pezullojë, që Këshilli i Ankesave nuk duhet të hyjë për pezullim vendimi direct, pa prituri bordin e AMA-s. Bëhet fjalë për të njëjtin institucion. Ky është mendimi im.

Milva Ekonomi - AMA-s i janë lënë jo 7 ditë pune, por 10 ditë pune?

Gentian Sala - Këshilli i Ankesave të shkojë për titull ekzekutimi, pa pritur vendimin e bordit, i cili mund ta kthejë vendimin, për mua është *nonsens* brenda të njëjtit institucion...

Besmir Beja - Nëse mund ta shpjegoj, e drejta administrative njeh të drejtën që një vendim të ekzekutohet menjëherë, pavarësisht se ndaj atij vendimi është ushtruar ankim në organin epror. Është rast përjashtimor, por njihet nga Kodi i Procedurave Administrative. Njihet edhe rasti tjetër, rregull. Parimi është që në rast se bëhet ankim administrativ jogjyqësor ndaj një vendimi të një organi në organin epror, si rregull pezullohet ekzekutimi. Propozimi ka ardhur që në këtë lloj rasti, për shkak të nevojës që ka për të mbrojtur apo për të balancuar interesat ndërmjet vendimit që ka marrë Këshilli i Ankesave dhe duke pasur në konsideratë afatin shumë të shkurtër që ka bordi i AMA-s për të shqyrtuar anikimin, nuk e pezullon atë. Sidoqoftë është në tagrin tuaj për të vlerësuar nëse ky lloj propozimi është në përputhje me...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të dyja alternativat janë të vlefshme në përputhje si me legjislacionin, kuadrin tonë në fuqi, përkatësisht Kodin e Procedurave Administrative, po ashtu edhe me praktikën më të mira ndërkombëtare. Janë të dyja praktika të njohura, është thjesht vlerësimi se cila është zgjidhja më efektive, se si mundet që ky lloj rasti të shqyrtohet më shpejt.

Bujar Çela – Kemi kaq shumë orë që diskutojmë: “e lagu, nuk e lagu”. Ne, si deputetë, në këtë komision prej kaq ditësh kemi pasur dilemën: e vendos AMA gjobën dhe do të ekzekutohet pa shkuar në gjykatë? Tani na shtohet edhe një hallkë tjetër e ndërmjetme: e vendos Këshilli i Ankesave të shkojë tek AMA, pastaj ta çojmë te gjykata. Duket një procedurë shumë e gjatë procedura e ekzekutimit dhe shumë të drejta që enden rrugës. Këtu nuk mbrojmë as konsumatorin, ai që është ndëshkuar nga lajmi i rremë, Adilin, por as Ismetin që ka prodhuar lajmin.

Milva Ekonomi - Si doni të procedojmë për këtë gjë? Doni ta hedhim në votim, të vazhdojmë, apo doni më tepër kohë për ta menduar?

Ismet Beqiraj - Sigurisht që edhe media, edhe qytetarët na kuptojnë, që në finale është bërë një punë shumë e mirë. Edhe gjatë dëgjësive, janë pasqyruar të gjitha shqetësimet e të gjitha palëve të interesit dhe janë përfshirë në këtë draft edhe sugjerimet e ekspertëve të huaj, që operojnë në vendin tonë, por edhe të atyre që e kanë parë këtë paketë antishpifje me skepticizëm. Kam një propozim në lidhje me vendimarrjen ose kthjellimin e saktë të këtij ngërçi institucional brenda një institucioni për dy organe. Unë gjykoj që si komision edhe të qëndrojmë gjithë natën, nuk do të mbarojmë punë, por do të sugjeroja që ekspertët përkatës qoftë të parlamentit, qoftë të

ministresë apo të AMA-s, relatori, sekretaria juridike e komisionit të na sjellin një draft. Me të drejtë e tha zoti Bujar: “e lagu, nuk e lagu” nuk do të mbarojmë kurrë. Të na sjellin 2-3 variante dhe ta kalojmë.

Milva Ekonomi - Faleminderit!

Do ta lëmë këtë nen pa marrë një vendim. Do të kërkojmë të kemi pak më shumë komente për këtë, të shikojmë pak më tepër eksperiencat ndërkombëtare.

Kalojmë te neni 30. Në këtë nen janë bërë këto ndryshime të nenit 133. Janë parë me grupin e ekspertëve të OSBE-se dhe me grupin e punës.

Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë: “Shkeljet e mëposhtme të kryera nga OSHMA-ja dhe OSHPE-ja, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, por përbëjnë kundërvajtje administrative dënohen si më poshtë:

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

Me gjobë nga 100 mijë deri në 1 milion lekë në rastet kur nuk respektohen detyrimet që rrjedhin nga nenet 33, 33/1 të këtij ligji.

2/I. Nuk zbaton afatin e ruajtjes së regjistrimit të transmetimeve sipas përcaktimeve të nenit 37 të këtij ligji në masën që duhet (sepse është bërë gabim). Gjoha bëhet në masën 40 mijë deri në 800 mijë, kur nuk respekton vendimin e Këshillit të Ankesave ose të drejtën e përgjigjes sipas nenit 53 të këtij ligji. Përsëritja e shkeljes më shumë se 3 herë gjatë këtij viti dënohet me një rritje 50% të shumës së gjobës së përmendur më lartë. Në rast se përsëritet më shumë se 5 herë gjatë vitit të kaluar, subjekti nuk do të përfitojë lehtësira fiskale apo të ndonjë lloji tjetër për një periudhë 3-vjeçare”.

3. Në pikën 2, shkronja “a” ndryshon si më poshtë:

Në fjalinë e parë numri “120 mijë” zëvendësohet me numrin “800 mijë”.

4. Në pikën 10, para fjalës “inspektorë” shtohen fjalët “Këshilli i Ankesave”.

5. Në fund të fjalisë së dytë të pikës 11, shtohen fjalët si më poshtë: “Sipas parashikimeve të nenit të këtij ligji, bazuar në parimin e proporcionalitetit”.

Ky ligj hyn në fuqi ...

Neni 31 është ...

Jemi te neni 30.

A ka nevojë ky nen për diskutim?

Unë dhe zoti Ulqini, si dy relatorë, kemi një propozim.

Mund të flisni, zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Në respekt të diskutimit që u bë këtu, si në komisionin tjetër apo në publik, dhe në respekt të asaj çfarë është thënë shumë qartë në ligj, edhe në fund të nenit 30, ku citohet parimi i proporcionalitetit, ne propozojmë që OSHMA-ja dhe OSHPE-ja të mos trajtohen njësoj për gjobën. Pra, një televizion dhe një radio të mos kenë të njëjtën gjobë si një portal, për të njëjtën shkelje. Mendojmë të zbatojmë parimin e proporcionalitetit, sepse një portal ka të punësuar 5 veta, ndërsa një televizion kombëtar ka të punësuar 100 veta. Gjoka duhet të ketë një diferencë dhe të jetë 100 mijë. 10 milionë të vjetër të jetë për OSHMA-të, por jo për OSHPE-të. E lëmë siç ka qenë në ligjin e vjetër, nga 100 mijë deri në 400 mijë për portalet dhe nga 100 mijë deri në 1 milion për radiot dhe televizionet.

Ky është propozimi ynë, që respekton dhe, si të thuash, është shqetësimi i OSBE-së, është shqetësimi ynë dhe ka një logjikë, pasi edhe vetë ligji kërkon të zbatohet parimi i proporcionalitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Jeni dakord?

Mirela Kumbaro – Jam edhe unë dakord me propozimin e deputetit Ulqini.

Milva Ekonomi – Ne të dy, si relatorë, kemi këtë propozim.

Ka komente për pikën 2, shkronja “a”?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne mendojmë që të ketë një diferencë midis OSHMA-ve dhe OSHPE-ve. Mendojmë se OSHPE-të nuk mund të kenë të njëjtën masë gjoke si OSHMA-të. Mendojmë se duhet të garantojmë proporcionalitetin, të vëmë një gjobë proporcionale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Masën e sipërme, tavanin, ta ulim dhe dyshtemenë ta mbajmë siç është.

Të dëgjojmë Ministrinë e Drejtësisë, sepse kanë një koment.

Besmir Beja – Kemi një sugjerim. Masa e gjobës të jetë e bazuar në kritere objektive. Pra, forumi, mediumi i medias jo domosdoshmërisht është kriter i mjaftueshëm objektiv për të bërë dallimin ndërmjet gjobës. Një kriter mjaftueshëm objektiv mund të jetë qarkullimi ekonomik. Pra, pavarësisht se mund të jetë një portal *online*, qarkullimi ekonomik mund të jetë po aq sa në një televizion. Dallimi në këto raste do të ishte i pajustificuar. Mbase është e drejtë që duhet të ketë trajtime të ndryshme në respekt për gjobën, por duhet përzgjedhur kriteri. Jo domosdoshmërisht

duhet të jetë mediumi në të cilin transmetohet ose funksionon media, por një kriter tjetër më objektiv, i ndryshëm nga mediumi.

Milva Ekonomi – Ju keni shumë të drejtë.

Në fakt, kur ne diskutuam, u mbështetëm në raportin e Institutit të Medies Shqiptare “Për 25 parimet e zbatimit në medien shqiptare të standardeve të BE-së”, në 2 faqet e para të këtij raporti, ku është një përmbledhje për shifrat financiare dhe të punësimit në mediet e ndryshme të Shqipërisë. Ne pamë bilancin vjetor të televizioneve, bilancin vjetor të radiove dhe përqindjen e reklamave që fitonte secili nga mediumet. Mediumi që fiton më pak, pa dyshim që janë mediet e shkruara, por mediet në internet fitojnë 10 herë më pak se mediet audiovizive, ndaj menduam që ka nevojë për rregullim.

Mirela Kumbaro – Propozimi që vjen i sqaruar nga informacioni i dy relatorëve, nuk është thjesht për dallimin e suportit, nëse janë audiovizivë apo portale *online*. Të mos harrojmë se mediet audiovizive janë më shumë tradicionale, më të konsoliduara, kanë një histori dhe një raport investim-kapital *turn-over* dhe një fitim shumë më të madh, konfirmuar edhe me shifra. Jemi në fillim të portaleve *online*, në 3-4 vjetët e para, dhe zhvillimin e tyre, që bëri të nevojshëm rregullimin e këtij fenomeni të ri. Besoj se jemi korrektë me këtë raport dhe ndoshta pas 10 vjetësh, nëse do të kemi një zhvillim të ri ekonomik, ku do të dominojë një *turn-over* më i lartë i portaleve, ta rikonsiderojnë ligjvënësit e asaj kohe. Kështu respektojmë edhe mediet audiovizive, që kanë 3 dekada, edhe këto që kanë 3 vjet, le të themi.

Musa Ulqini – Më falni, dua të shtoj edhe diçka.

Kur u hartua ligji për mediet elektronike, u kemi lënë 3 vjet afat të standardizohen me kërkesat e ligjit; u kemi dhënë një suport, nuk i kemi detyruar, sidomos ato kombëtares, të respektojnë pikë për pikë. Nëse një medie kombëtare elektronike, një televizion ose një radio duhet të mbulonte 85% të popullsisë, siç e ka edhe ligji, që të marrë një licencë kombëtare, ne u kemi lënë një afat 3-vjeçar, sepse kemi dashur ta ndihmojmë. Ligji bëhet për t'i ndihmuar, jo për t'i penguar. Propozimi ynë saktësisht bie ndesh me të gjitha ato që thuhet, që ne po u mbyllim gojën. Përkundrazi, me propozimin që bëmë dhe me atë që është thënë në ligj, duke pasur një trajtim, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, ne po e ndihmojmë medien *online*, si një medie të re.

Kemi edhe një precedent, dhe unë flas si kryetar i grupit të punës dhe i komisionit të asaj kohe, që është vlerësuar pozitivisht nga të gjithë aktorët dhe faktorët shqiptarë dhe ndërkombëtarë.

Gentian Sala – Unë jam dakord me propozimin, duke pasur parasysh edhe faktin që një medie *online* bën me dhjetëra e dhjetëra lajme gjatë gjithë ditës dhe mundësinë “të gabojë” e ka shumë më të lartë sesa media tradicionale që jep lajmet në orë fikse.

Milva Ekonomi -Dakord.

Jeni dakord të miratohet ky nen me ndryshimet që propozojnë relatorët?

Dakord.

Nuk e kalojmë dot miratimin në tërësi, sepse një pikë e nenit 29 është e paqartë. Mendoj se duhet të shikojmë të gjitha eksperiencat ndërkombëtare, pjesën e legjislacionit kombëtar, që të bëjmë një riformulim më të mirë.

Do t’ju propozoja që nesër në orën 9:00 të zhvillojmë një mbledhje, nga e cila do t’i japim detyrën sekretarisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe vetes, kush lexon anglisht, të shikojë Kroacinë, Gjermaninë dhe Francën për këtë gjë. Duhet të presim 2 orë derisa të mbarojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Propozojmë ta mbyllim. T’i japim kohë grupit të punojë 2 orë dhe të rikthehemi në sallë.

(Diskutimi pa mikrofon.)

Duhet të lexojnë, duhet të shikojnë.

Gentian Sala – Vendoset gjobë, ankohet subjekti, e shqyrton bordi, shkon për titull ekzekutiv. Ne nuk e kemi praktikë, po funksionojmë kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë e vendosni. Pse të shikojmë Kroacinë, kur ne kemi praktikë shumë të mire?! Institucioni funksionon, nuk ka pasur asnjë gjobë të Autoritetit të Medieve të hedhur poshtë nga gjykata.

Milva Ekonomi – Do ta shikojmë.

(Diskutimi pa mikrofon.)

Na jepni 30 minuta kohë.

(Diskutimi pa mikrofon.)

1 orë.

(Diskutimi pa mikrofon.)

Të shikojmë praktikën dhe të vijmë pas 1 orë.

(Pas pushimit)

Milva Ekonomi - Kolegë, mund të fillojmë diskutimin për pikën 6, që e rishikuam me Komisionin e Ligjeve dhe Ministrinë e Drejtësisë, duke parë edhe raportet e tjera që kanë ardhur këtu dhe atë që ka thënë OSBE-ja?

Pika 6 e nenit 29 riformulohet si më poshtë vijon:

“Subjekti i ndëshkuar mund të bëjë ankim pranë Bordit të AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të Këshillit të Ankesave për vendimet, sipas parashikimeve të neneve 33/1, 51/1, 53/1 të këtij ligji. Ankimi ndaj vendimeve të Këshillit të Ankesave nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Bordi i AMA-s shqyrton ankesën dhe shpall vendimin jo më vonë se 10 ditë. Kundër vendimit të Bordit të AMA-s mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Pika 8 e nenit 29 hiqet.

Jeni dakord me riformulimin e pikës 6 të nenit 29? Dakord.

Jeni dakord me heqjen e pikës 8 të nenit 29? Dakord.

Ka ngelur për t’u miratuar neni 31 “Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Natyrisht që për këtë nen jemi dakord.

Bëmë diskutimin në parim, e miratuam projektligjin në parim. Bëmë diskutimin nen për nen, që na mori shumë kohë; angazhuam Komisionin e Ligjeve dhe ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë, të AKEP-it dhe të AMA-s.

Ju falënderoj, kolegë, për orarin e gjatë të punës, që ndatë me ne dhe gatishmërinë e zonjës Ferhati, që erdhi menjëherë sapo patëm nevojë të konsultonim opinionet tona!

Falënderoj edhe gazetarët, që nuk u lodhën me ne sot!

(Diskutimi pa mikrofon.)

Mund ta rilexoj, sepse e meritoni për durimin që patët.

Neni 29 pëson disa ndryshime në pikën 6 të tij. Ne e lamë ta riformulojmë pasi të konsultoheshim me ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionin e Ligjeve, të lexonim të gjitha shënimet nga grupet ndërkombëtare të ekspertëve, por edhe nga ato që kishim hulumtuar në bibliotekën e parlamentit. Neni 29, pika 6, riformulohet si më poshtë vijon:

“Subjekti i ndëshkuar mund të bëjë ankim pranë Bordit të AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të Këshillit të Ankesave për vendimet, sipas

parashikimeve të neneve 33/1, 51/1, 53/1 të këtij ligji. Ankimi ndaj vendimeve të Këshillit të Ankesave nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Bordi i AMA-s shqyrton ankesën dhe shpall vendimin jo më vonë se 10 ditë. Kundër vendimit të Bordit të AMA-s mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Pika 8, që lidhet me pikën 6 të nenit 29, hiqet.

Pika që hiqet është: “Kundër vendimit të Këshillit Administrativ të AMA-s mund të bëhet ankim, sipas dispozitave të pikës 6 të këtij neni. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave”.

Ne e votuam. Edhe një herë, meqenëse media është ende këtu, jeni dakord me këto ndryshime?

Kalojmë në miratimin në tërësi të projektligjit.

Jeni dakord me miratimin në tërësi të projektligjit? Kush është kundër? Nuk ka.

Sekretaria dhe relatorët duhet të punojnë për të hartuar raportin përfundimtar, edhe pse pjesa më e madhe ka qenë e gatshme.

Ju falënderoj për angazhimin, për durimin dhe për këmbënguljen që ta mbyllnim këtë projektligj sipas kalendarit!

Faleminderit medias për durimin dhe këmbënguljen që patët për të qenë prezent në kohën që zhvillohej kjo mbledhje!

Ju falënderoj të dashur kolegë, miq të mirë, të papërtuar, të palodhshëm!

MBYLLET MBLEDHJA

